



DOKUMENTI I POLITIKAVE TË PENSIONEVE

TABELA E PËRMBAJTJES

1). Hyrje.....	4
2). Sistemi i pensioneve në Shqipëri.....	5
2.1. Historik i shkurtër i sistemit të pensioneve para vitit 1993.....	5
2.2. Sistemi aktual i pensioneve.....	7
2.3. Formula e llogaritjes së masës së pensionit mujor.....	9
2.4. Ecuria e treguesve kryesorë ndër vite dhe problemet e konstatuara.....	11
3). Parashikimi afatgjatë i treguesve të sistemit aktual të pensioneve.....	17
4). Opsionet e propozuara për reformimin e sistemit të pensioneve.....	20
5). Përfundim.....	32
6). Shtojca 1: Mbi efektet financiare të rregullimeve të propozuara në skemat suplementare, të trajtimit financiar të të punësuarve në rast sëmundjeje si edhe trajtimit të grave të siguruara lidhur me përfitimet për barrëlindje.....	34
7). Shtojca 2: Mbi të dhënat e përdorura dhe supozimet e bëra për projeksionet afatgjata të treguesve kryesorë të skemës së pensioneve.....	41

TREGUESI I FIGURAVE, KUTIVE DHE TABELAVE

Lista e Figurave

Fig. 1 – Numri i kontribuesve për vite të përzgjedhura.....	12
Fig. 2 – Numri i përfituesve për vite të përzgjedhura.....	12
Fig. 3 – Numri i kontribuesve krahasuar me popullsinë në moshë pune 2005-2013.....	13
Fig. 4 – Të ardhurat dhe shpenzimet e sistemit të sigurimeve shoqërore për vite të përzgjedhura (në mln Lek).....	14
Fig. 5 – Rritja e masës së pensionit në zonat urbane e rurale (në %).....	15
Fig. 6 – Masa e pensionit në zonat urbane (në Lek).....	16
Fig. 7 – Masa e pensionit në zonat rurale (në Lek).....	16
Fig. 8 – Projektion i grupmoshave ndaj totalit të popullsisë.....	17
Fig. 9 – Projektion i koeficientit të varësisë së të moshurave.....	18
Fig. 10 – Projektion i numrit të pensionistëve ndaj totalit të popullsisë.....	18
Fig. 11 – Projektion i shkallës së mbulimit të të punësuarve.....	18
Fig. 12 – Projektion i normës së varësisë së sistemit.....	18
Fig. 13 – Projektion i shkallës së zëvendësimit.....	19
Fig. 14 – Projektion i të ardhurave dhe shpenzimeve.....	19
Fig. 15 – Projektion i deficitit të skemës (% e PBB).....	19
Fig. 16 – Projektion i shkallës së zëvendësimit nën skemën aktuale dhe Opsionin 1.....	22
Fig. 17 – Projektion i të ardhurave, shpenzimeve dhe deficitit (% e PBB) nën opsionin Opsionin 1.....	23
Fig. 18 – Projektion i balancës (% e PBB) nën skemën aktuale dhe Opsionin 1.....	24
Fig. 19 – Projektion i balancës (% e PBB) nën skemën aktuale, Opsionin 1 dhe Opsionin 1-Pesimist.....	25
Fig. 20 – Projektion i numrit të përfituesve të pensionit të pleqërisë.....	29
Fig. 21 – Projektion i normës së zëvendësimit nën skemën aktuale dhe Opsionet1 dhe 2.....	30
Fig. 22 – Projektion i balancës (% e PBB) nën skemën aktuale dhe Opsionin 2.....	30
Fig. 23 – Projektion i balancës (% e PBB) nën skemë aktuale, Opsionin 2 dhe Opsionin 2-Pesimist.....	31
Fig. 24 – Projektion i balancës (% e PBB) nën skemën aktuale dhe Opsionet 1 dhe 2.....	32
Fig. 25 – Projektion i balancës (% e PBB) nën skemë aktuale dhe varianteve pesimist të Opsioneve 1 dhe 2.....	33

Lista e Kutive

Kutia 1 – Mbi kontributet dhe përfitimet në skemën rurale.....	10
Kutia 2 – Mbi numrin e përfituesve dhe koston e pensionit social për periudhën 2015-208.....	26

Lista e Tabelave

Tabela 1 – Norma e varësisë së skemës së pensioneve deri në vitin 1993.....	5
Tabela 2 – Kontributet në sistemin e sigurimeve shoqërore (si % e pagës).....	7

1. HYRJJE

Sistemi i pensioneve në Shqipëri i ka përmbushur funksionet e tij themelore gjatë tranzicionit dhe tani vuan nga disa probleme të mprehta që e bëjnë reformimin e tij të domosdoshëm. Së pari, skema jep përfitime të ulëta për disa kategori dhe, ç'është më e rëndësishmja, përfitimet do vazhdojnë të ulen edhe më shumë në rast se skema nuk reformohet. Së dyti, skema karakterisohet nga elementë të theksuar padrejtësie sepse disa grupe kontribuesish përfitojnë pensione shumë të larta dhe kontribojnë shumë më pak se të tjerët. Është e natyrshme që sistemet e pensioneve të kenë një farë rishpërndarjeje tek më të varfërit apo kategoritë e tjera. Gjithsesi, nëse rishpërndarja është shumë e lartë skema e pensioneve mund të konsiderohet e padrejtë dhe pjesëmarrja në të nis e bie. Së treti, skema e pensioneve vuan nga një deficit i lartë që e bën atë financiarisht të papërbalueshme. Së katërti, ndonëse të gjithë të moshuarit janë të mbuluar nga skema falë punësimit të plotë gjatë komunizmit, një pjesë e madhe e popullsisë në moshë pune sot është e pa siguruar për shkak të papunësisë së lartë por edhe informalitetit. Kjo gjë e ka përkeqësuar ndjeshëm raportin mes kontribuesve dhe përfituesve dhe lë të kuptohet se në të ardhmen shumë të moshuar nuk do marrin fare pension pleqërie. Në këtë mënyrë, sistemi shqiptar i pensioneve nuk është më në gjendje të barazpeshojë mjaftueshmërinë e përfitimeve me përballueshmërinë e shpenzimeve. Duke parë rëndësinë që pensionet kanë për mbrojtjen sociale, është e nevojshme që të ndërhyhet menjëherë për reformimin e sistemit.

Materiali i mëposhtem është hartuar në zbatim të urdhërit të Kryeministrit nr. 7, datë 17.01.2014, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për bashkërendimin dhe mbikqyrjen e procesit të përgatitjes së reformës në fushën e pensioneve." Ky dokument pune është strukturuar si vijon. Kapitulli 2 përshkruan karakteristikat kryesore të sistemit aktual të pensioneve, ecurinë e treguesve të tij si edhe problemet me të cilat ky sistem përballlet sot. Kapitulli 3 bën një parashikim afatgjatë të treguesve kryesorë të skemës së sotme të pensioneve. Kapitulli 4 jep dy opsione se si mund të reformohet skema e pensioneve si edhe projeksione afatgjata të treguesve kryesorë të këtyre opsioneve. Kapitulli i fundit përmbyll dokumentin.

2. SISTEMI I PENSIONEVE NË SHQIPËRI

2.1. Historik i shkurtër i sistemit të pensioneve para vitit 1993

Vendosja e një sistemi të plotë të sigurimeve shoqërore në Shqipëri evidentohet në vitin 1947. Sistemi fillestar i sigurimeve shoqërore u konsolidua gradualisht në dy skema: një për të punësuarit e sektorit shtetëror dhe një tjetër për anëtarët e kooperativave bujqësore.

Ky sistem ishte shumë bujar dhe siguronte mbrojtje të plotë sociale. Ai parashikonte mosha të ulta të daljes në pension dhe trajtim të diferencuar për kategori të caktuara të punësuarish. Sistemi financohej nga kontributet e punëdhënësve shtetërorë dhe të kooperativave bujqësore, të cilët natyrshëm ishin pjesë e kostos dhe e çmimeve të planifikuara. Ne themel sistemi bazohej në solidaritetin e brezave, ku me kontributet e paguara financoheshin përfitimet e përcaktuara gjatë asaj periudhe, dhe ndërkohë, nëpërmjet tyre të punësuarit siguronin të drejta të ardhshme në fushën e sigurimeve shoqërore.

Deri në vitin 1991 numri i të punësuarve në ish-ndërmarrjet shtetërore dhe në ish-kooperativat bujqësore, të cilët përbënin edhe kontribuesit në sistemin e sigurimeve shoqërore, ishte 1 milion e 446 mijë. Përfituesit e parë të sistemit filluan të përfitonin pensione në vitin 1960. Sipas statistikave të kohës, në vitin 1966 evidentohen rreth 35 mijë përfitues, kryesisht me pensione të pjesëshme, kundrejt 263 mijë kontribuesve. Në fund të vitit 1991 numri i përfituesve kishte arritur në 329 mijë, duke reflektuar një normë vartësie 4.5 kontribues për 1 përfitues, krahasuar me 7.4 kontribues për çdo përfitues në vitin 1966.

Tabela e mëposhtme pasqyron kontribuesit dhe përfituesit e sistemit në disa vite. Numri i kontribuesve është rritur vit pas viti dhe po kështu edhe numri i përfituesve. Fillimisht, në vitet e para, norma e vartësisë së sistemit ka qenë mjaft e favorshme, ç'ka bënte të mundur mbajtjen e një norme mjaft të ulët të kontributit ndaj pagës. Në vitin 1991, raporti kontribues-përfitues ishte 4.5 me 1, me një normë kontributi prej 15% të pagës.

Tabela 1 - Norma e varësisë së skemës së pensioneve deri në vitin 1993

	1966	1976	1986	1990	1991	1993
Totali i kontribuesve	262,830	520,150	750,982	1,451,212	1,347,616	731,000
Pensione Urbane	35,222	88,242	161,704	206,541	244,159	304,020
Pensione Rurale		28,814	81,893	112,566	121,502	149,917
Totali pensionistëve	35,222	117,056	243,597	319,107	365,661	453,937
Raporti kontribues/përfitues	7.4:1	4.4:1	3:01	4.5:1	3.7:1	1.6:1

Numri i kontribuesve pësoi një rënie drastike në vitin 1993, por në fakt këtë vit numri i kontribuesve ishte akoma edhe më i ulët. Kjo për faktin se në shumë ndërmarrje shtetërore një pjesë e madhe e punëtorëve merrnin pagesë papunësie të financuar nga buxheti i shtetit në masën

60% të pagës dhe njëkohësisht evidentoheshin edhe si kontribues. Në vitin 1994, kur edhe u ndërpre në këto pagesa, numri i kontribuesve ra në 386 mijë. Nga ana tjetër, mbyllja e ndërmarrjeve shtetërore bëri të nevojshme vendosjen e skemave të pensioneve të parakohëshme dhe si rrjedhim numri i pensionistëve në vitin 1993 u rrit me 123 mijë duke shkuar në 453 mijë në total.

Në sistemin e pensioneve para vitit 1993, pensioni maksimal ishte përcaktuar se nuk mund të ishte më i lartë se dyfishi i pensionit minimal (pensioni maksimal ishte 700 lekë në muaj, ndërsa pensioni minimal 350 lekë), pavarësisht nga paga, ndërkohë që edhe pagat mbi të cilat paguheshin kontributet ishin në raportin 1 me 2. Për ish-anëtarët e kooperativës, pensioni minimal ishte 100 lekë në muaj, ndërkohë që pensioni maksimal jo më shumë se 350 lekë. Sipas të dhënave të kohës, pensioni mesatar ishte rreth 460 lekë, ose rreth 30% më i lartë se pensioni minimal.

Të dy sistemet e pensioneve u zhvilluan dhe u zbatuan deri në fund të vitit 1993, duke lënë për legjislacionin e ri, që do të ndërtohej në përputhje dhe në koherencë me zhvillimet e reja ekonomike, një detyrim të hapur, kryesisht në dy drejtime: Sistemi i ri që do të ndërtohej, nga njëra anë, do të përballonte dhe zhvillonte të gjitha pagesat për përfitimet e njohura dhe, nga ana tjetër, ky sistem ishte i detyruar të njihte dhe konsideronte të mirëqenë të gjithë periudhën e sigurimit të çdo pjesëmarrësi në skemat e mëparshme. Të drejtat e fituara nga sistemi i mëparshëm, të cilat do të zbatoheshin në vitet e ardhshme, ishin të konsiderueshme. Mjafton të përmendim këtu që përveç rreth 453 mijë pensioneve që duheshin paguar çdo muaj, ishte akumuluar si e drejtë e fituar një periudhë sigurimi e konsiderueshme për mbi 1 100 mijë persona.

Në këto kushte të vështira ekonomike, u përcaktuan edhe parimet bazë të sistemit aktual të pensioneve, i cili:

- do të vazhdonte të ishte kontributiv;
- do të zbatonte një skemë solidariteti me financim ndër-brezor;
- do të mbante parasysh të drejtat e fituara për mbi 1450 mijë kontribues;
- do të vazhdonte të zbatonte të ndara dy skema pensionesh nje për punonjësit me historik pune në ish ndermarjet shtetërore dhe një për ish punonjësit e kooperativave bujqësore, kjo për shkak të historikut të ndryshëm të kontributeve, të cilat do të duhej të harmonizoheshin përgjatë viteve në vazhdim;
- do të vazhdonte të mbante në funksion tavanet e masës së përfitimeve si dhe do të duhej të vendoste një shumë bazë, e cila i përgjigjej një kontributi bazë, dhe që do të përfaqësonte minimumin jetik.

2.2. Sistemi aktual i pensioneve

Ligji nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), krijoi një sistem të detyrueshëm, publik dhe me mbulim universal të sigurimeve shoqërore dhe një kolonë suplementare vullnetare, e cila momentalisht nuk paraqitet e zhvilluar me gjithë masat që janë marrë dhe kuadrin ligjor tashmë të plotësuar.

Sistemi i detyrueshëm përbëhet nga:

- i. **Një skemë sigurimesh shoqërore e detyrueshme** që administrohet nga Insituti i Sigurimeve Shoqërore dhe mbulon të punësuarit në shtet dhe në sektorin privat dhe të vetëpunësuarit në zonat urbane dhe rurale, me kusht që ata të kenë kontribuar për një kohë të përcaktuar në skemë.
- ii. **Një skemë vullnetare** që përfshin ata që nuk janë më të siguar, që kanë qenë dhe duan të vazhdojnë të jenë si edhe ata që nuk janë të mbuluar nga ligji përfshi edhe studentët e universitetit.
- iii. **Një skemë suplementare** për funksionet e larta kushtetuese, shërbimin civil dhe ushtarakët e punësuar në ushtri, në polici dhe në shërbimin informativ. Pensionet suplementare financohen drejtëprdrejt nga buxheti i shtetit.
- iv. **Pensione të veçanta** për ata që kanë marrë pjesë në luftë, që kanë tituj në fushën e kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës si edhe të përndjekurit nga regjimi totalitar. Pensionet e veçanta financohen gjithashtu drejtëprdrejt nga buxheti i shtetit.

Ligji i sigurimeve shoqërore u jep mbrojtje të punësuarve edhe në rastin e **sëmundjeve, papunësisë, aksidenteve në punë dhe në rastin e barrëlindjes**. Aktualisht për sigurimet shoqërore norma e kontributit është 24.5%, dhe nga kjo 21.6% paguhen për degën e pensioneve. Më poshtë jepet një ndarje e normës së sigurimeve shoqërore dhe e sigurimit shëndetësor.

Tabela 2 - Kontributet në sistemin e sigurimeve shoqërore (si % e pagës)

Degët e sigurimeve	Totali	Punëdhënësi	Punëmarrësi
Pensione	21.6	12.8	8.8
Sëmundje	0.3	0.2	0.1
Barrëlindje	1.4	0.8	0.6
Aksidente në punë	0.3	0.3	0
Papunësia	0.9	0.9	0
Totali i sigurimeve shoqërore	24.5	15	9.5
Sigurimi shëndetësor	3.4	1.7	1.7

Skema publike e pensioneve ofron tre lloje pensionesh: pensionin e pleqërisë, të invaliditetit dhe atë familjar.

A. Pensioni i pleqërisë.

Për të fituar të drejtën e një pensioni të plotë pleqërie, individit duhet të kontribuojë për një periudhë sigurimi të përcaktuar prej 35 vjetësh dhe mund të marrë pension kur mbush moshën 65 vjeç për burra dhe 60 vjeç për gra. Një pension pleqërie i reduktuar mund të përfitohet edhe deri në tre vjet para mbushjes së moshës, por me kushtin që të jetë plotësuar periudha e sigurimit prej 35 vitesh. Ky lloj pensioni shoqërohet me penalitete për daljen parakohe në masën 0.6% të masës mujore të pensionit për çdo muaj të dalë para kohe dhe kjo masë mbetet e tillë për gjatë gjithë jetës. Nga ky rregull bëjnë përjashtim vetëm punonjësit e nëntokës, të cilët dalin në pension në moshën 60 vjeç, si dhe nënat me shumë fëmijë të cilat dalin në pension në moshën 50 vjeç.

Personat që kanë mbushur moshën e daljes në pension dhe kanë derdhur kontribute për 35 vjet, pavarësisht nga zbatimi i formulës së llogaritjes për masën e pensionit, marrin një shumë mujore e cila nuk mund të jetë më e vogël se pensioni minimal, që përcaktohet çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Nga ana tjetër, edhe në rastet kur shuma mujore e pensionit, e llogaritur sipas formulës rezulton e lartë, ajo nuk mund të jetë më e madhe se pensioni maksimal që ligjërisht është sa dyfishi i pensionit minimal. Veç kësaj, pensioni i llogaritur sipas kësaj formule, nuk mund të jetë më i lartë se sa paga mesatare neto e realizuar për tre vjet radhazi në dhjetë vitet e fundit të punës shumëzuar me 75%. Edhe pas këtyre kufizimeve, në çdo rast pensionisti merr shumën më të vogël, e cila zgjidhet midis shumës që rezulton nga llogaritja sipas formulës, kufirit maksimal dhe llogaritjes me 75% të pagës neto.

Për rastet kur punonjësi ka kontribuar në skemë përtej moshës së daljes në pension ai përfiton një shtesë mbi pension prej 0.34% të pensionit shumëzuar me numrin e muajve që është punuar mbi moshë. Nga ana tjetër, personat e siguruar, që nuk e plotësojnë periudhën e përcaktuar me ligj prej 35 vitesh punë, në rast se kanë kontribuar në skemë për më shumë se 15 vjet, përfitojnë pension të pjesshëm pleqërie në momentin e plotësimit të moshës së pensionit dhe të ndërprerjes së aktivitetit ekonomik. Madhësia e pensionit të pjesshëm llogaritet duke u mbështetur tek formulat e llogaritjes së pensionit të plotë, por duke e korrektuar atë me një koeficient, që përcaktohet si raport i numrit të viteve që personi ka kontribuar në skemë dhe numrit 35 (që janë vitet e sigurimit për të fituar pension të plotë).

B. Pensioni i invaliditetit.

Personat e siguruar që nuk mund të vazhdojnë periudhën e sigurimit për shkaqe shëndetësore të cilat nuk kanë lidhje me punësimin, apo për shkak të dëmtimeve profesionale të shkaktuara në punë, fitojnë të drejtën e një pensioni invaliditeti. Periudha minimale e sigurimit e nevojshme për të përfituar një pension invaliditeti është sa moshë e invalidit minus 20 dhe rezultati pjestohet

me 2. Ndërsa në rastet kur dëmtimi i shëndetit është shkaktuar si pasojë e një aksidenti në punë apo sëmundje profesionale e drejta për përfitim lind pavarësisht nga periudha e sigurimit.

Pensioni mujor i invaliditetit llogaritet me të njëjtat rregulla si pensioni i pleqërisë, dhe mund të jetë i plotë ose i pjesshëm, në varësi të gjendjes shëndetësore, ose i reduktuar për shkak të mosplotësisimit të periudhës minimale të domosdoshme të sigurimit.

C. Pensioni familjar.

Kur një person, që ishte në pension, apo pritej të fitonte të drejtën e pensionit të pleqërisë apo të invalidit, vdes, atëhere personave që janë në ngarkim të tij iu lind e drejta për pension familjar. Llogaritja e masës së pensionit është e njëjtë si në rastin e pensionit të pleqërisë, por mund të jetë i plotë ose i pjesshëm, në varësi të anëtarëve pjesëmarrës në këtë pension, të cilët mund të jenë: fëmijët, bashkëshortja ose bashkëshorti dhe prindi.

2.3. Formula e llogaritjes së masës së pensionit mujor

Shuma mujore e pensionit varet nga periudha kontributive dhe madhësia e kontributeve të paguara. Madhësia e kontributeve mujore varet nga paga bruto dhe nga norma e përcaktuar e kontributit. Kontributet paguhen nga punëdhënësi dhe i punësuarit, ndërsa për të vetëpunësuarit e gjithë ngarkesa kontributive përballohet nga vetë ata. Për të vetëpunësuarit në zonat rurale kontributet llogariten sipas një procedure të caktuar me VKM, e cila përcakton tarifën vjetore të kësaj kategorie të punësuarish. Ndërkohë, Buxheti i Shtetit plotëson pjesën e kontributeve duke mbuluar diferencën mes asaj që individ i paguan vetë dhe kontributit minimal të përcaktuar në ligj. Niveli aktual i kontributeve që paguhet nga vetë individ është afërsisht 45% me 65% i minimumit që derdh një individ i vetëpunësuar në zonat urbane. Ligji i sigurimeve shoqërore iu jep mbrojtje të punësuarve edhe në rastin e sëmundjeve, papunësisë dhe barrë lindjes.

Pensioni mujor i pleqërisë llogaritet sipas formulës ligjore të mëposhtme:

$$P_p = M_{pb} + Sh$$

- **P_p** = Pensioni i plotë mujor i pleqërisë;
- **M_{pb}** = Masa e pensionit bazë që iu jepet të gjithë personave të siguruar. Ky komponent korrektohet çdo vit me indeksin e çmimeve të disa mallrave të perzgjedhura, siç parashikohet në Rregulloren e ISSH-së dhe përcaktohet çdo vit me VKM. Aktualisht, masa e tij është 12,024 lek në muaj në skenën urbane dhe 8,233 lekë në muaj në skemën rurale;
- **Sh** = Shtesa mbi pensionin bazë. Ky komponent është individual, varet nga madhësia dhe zgjatja e periudhës kontributive dhe është 1% për çdo vit sigurimi shumëzuar me

bazen mesatare të vlerësueshme. Në skemën rurale, shtesa mbi pensionin bazë llogaritet si 1% për çdo vit të siguruar pas 1994 shumëzuar me bazën mesatare të vlerësueshme. KM miraton çdo vit koeficientin e indeksimit të bazës së vlerësueshme, duke përdorur shkallën e rritjes së kontributeve mesatare individuale të vitit përkatës me atë të vitit paraardhës.

Aktualisht, baza mesatare e vlerësueshme llogaritet si mesatare e pagave që ka marrë i punësuar gjatë gjithë viteve të punës dhe mbi të cilat janë paguar kontribute. Duke qenë se përpara vitit 1994 nuk ka të dhëna për pagat individuale, për efekt të llogaritjes së bazës mesatare të vlerësueshme llogaritjet bëhen në bazë të pagave referuese të përcaktuara nga KM.

Siç shihet sistemi shqiptar i pensioneve zbaton një formulë tipike të përfitimeve të përcaktuara. Ndonëse në parim mënyra e llogaritjes së përfitimit të pensionit të pleqërisë merr parasysh numrin e viteve të sigurimit dhe madhësinë e kontributeve të paguara dhe rrjedhimisht iu jep pension më të madh atyre që kanë kontribuar më shumë në skemën e sigurimeve shoqërore, kufiri maksimal i pensionit, duke qenë taksativ, e dobëson vartësinë e përfitimeve nga madhësia e kontributeve.

Ndërsa në nivelin minimal arrihet një shkallë zëvendësimi prej 75% pension/pagë neto, ky raport në rastet e pagesës së kontributeve maksimale, për shkak të kufizimit nga tavan i pensionit maksimal, tenton gjithmonë drejt uljes dhe teorikisht për pagën maksimale mbetet në kufirin 35%. Pra, për këto paga, niveli i solidaritetit është shumë i lartë.

Mbi kontributet dhe përfitimet në skemën rurale

Sistemi i Sigurimeve Shoqërore i vendosur në vitin 1993 trashëgoi nga e kaluara dy skema të veçanta pensionesh, njëra për individët e punësuar në ndermarrjet shtetërore dhe tjetra për punonjësit e ish-kooperativave bujqësore. Skema e pensioneve për ish-kooperativat u modelua në vitin 1972 dhe hyri në fuqi në vitin 1974. Kushti kualifikues për pensionin e pleqërisë ishte 20 vjet antarësi në kooperative.

Pas shpërbërjes së kooperativave bujqësore (1992) dhe fermave shtetërore (1993), popullsia rurale në moshë pune përbëhet nga fermerë të vetëpunësuar dhe familjet e tyre. Në vitin 1994, rreth 166 mijë fermerë të moshuar dhe invalidë, ish antarë të kooperativave bujqësore përfitonin të ardhura sipas skemës së pensioneve të modeluar në vitin 1972 e cila siguronte pensione sa rreth 50% e pensioneve të qytetit, ndërsa rreth 82 mijë persona përfitonin të ardhura sipas rregullave për Ndihmën Ekonomike.

Aktualisht ISSH zbaton nenin 96 të ligjit nr. 7703 dhe jep pensione të reja fshati në rastet kur periudha e sigurimit është e lidhur vetëm me punën në ish kooperativat bujqësore dhe pensione të përbëra nga dy pjesë kur periudhës së sigurimit në kooperativat bujqësore i janë shtuar edhe kontribute të derdhura si person i vetpunësuar në bujqësi. Për sa u përket kontributeve, masa e kontributit është e shtetë dhe caktohet çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Më pas llogariten kontributet që duhet të derdreshin në bazë të pagës minimale si një i vetpunësuar në zonat urbane dhe buxheti i shtetit mbulon diferencën mes tyre.

Mesatarisht, shuma e kontributeve të fermerëve është afërsisht sa 53% e kontributeve që derdhen të vetpunësuarit në zonat urbane. Gjithsesi, ndonëse fermerët derdhen një kontribut shumë të ulët shuma aktuale e pensioneve të reja është e njëjtë si në skemën urbane.


Politikat e ndjekura deri tani i kanë mbajtur kontributet shumë të ulëta ndërkohë që masa e pensionit është rritur shumë më shumë sesa masa e pensionit të qytetit. Aktualisht, kontributet e drejtpërdrejta që paguhen nga të vetpunësuarit në bujqësi mbulojnë vetëm 18.7 % të shpenzimeve për pensionet rurale. Veç kësaj, pavarësisht subvencioneve të kontributeve nga buxheti i shtetit, këto subvencione bashkë me kontributet e drejtpërdrejta arrijnë të mbulojnë vetëm rreth 66% të shpenzimeve. Nga ana tjetër, në ligjin aktual është përcaktuar se një fermer merr pension qyteti kur veç punës në ish kooperativat bujqësore ka më shumë se 17,5 vite të siguruara si i vetpunësuar në bujqësi. Kjo ka shkaktuar që shumë fermerë pasi plotësojnë keto kushte nuk kontribuojnë më në skemë.

Por pavarësisht këtyre kushteve shumë favorizuese për banorët e zonave rurale, pjesëmarrja e tyre në skemën e pensioneve mbetet shumë e kufizuar.

2.4.Ecuria e treguesve kryesorë ndër vite dhe problemet e konstatuara


Numri mesatar vjetor i kontribuesve në vitet e para të zbatimit të skemës ka rënë në mënyrë drastike, duke shënuar kulmin në vitin 1997. Pas këtij viti vërehet një rritje graduale e numrit të kontribuesve, duke arritur maksimumin në vitin 2011, me 692 mijë; ndërsa aktualisht numri i kontribuesve të drejtpërdrejtë është rreth 643 mijë. Rritja e kontribuesve në skemë ka ardhur kryesisht nga rritja e numrit të kontribuesve në fshat si pasojë e kushteve favorizuese të pagesave kontributive të miratuara me ligj, edhe pse ky numër mbetet ende mjaft i ulët në raport me numrin total të të vetpunësuarve në zonat rurale. I krahasuar me numrin total të përfituesve, raporti kontribues-përfitues rezulton të jetë në nivele mjaft kritike.

Fig 1. – Numri i kontribuesve për vite të përzgjedhura



Treguesi i numrit të përfituesve, pas një rritjeje drastike në tre vitet e para të tranzicionit, fillon e normalizohet në vitet e mëvonshme, me rritje graduale deri në vitin 2002. Pas vitit 2002, si rezultat i reformës për rritjen e moshës së pensionit, kemi një rënie të ritmit të shtimit të pensioneve të reja.

Fig 2. – Numri i përfituesve për vite të përzgjedhura




Norma e varësisë, që shpreh raportin e përfituesve ndaj kontribuesve të skemës së sigurimeve shoqërore, është përqësuar nga vit në vit, duke arritur në 1.1 kontribues për 1 përfitues në vitin 2013. Megjithëkëtë, mbi madhësinë e koeficientit të varësisë vazhdojnë të ndikojnë negativisht

disa faktorë: numri ende i ulët i të punësuarve, përqindja e të papunëve ndaj forcave të punës mbetet shumë e lartë, shkalla akoma e lartë e punësimit në të zezë, përfshirja në skemë e disa kategorive specifike pensionesh, siç janë ato të parakohëshme, të cilat vazhdojnë të mbarten në skemën e detyrueshme, si edhe rritja e numrit të pensionistëve si rezultat i përfundimit të reformës së rritjes së moshës dhe rritjes së madhe natyrore të popullsisë së lindur pas Luftës së Dytë Botërore, të cilët tani kapin moshën e daljes në pension. Vlen të theksohet se në numrin e kontribuesve, për të llogaritur këtë koeficient, përfshihen edhe të vetëpunësuarit në bujqësi, që paguajnë një shumë fikse, si dhe kategori të cilëve me ligje të veçanta kontributet iu paguhen nga buxheti i shtetit si pensionet e parakohëshme të-ish ushtarakëve, vitet e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, vitet e shkollës së lartë për gratë, trajtimeve të veçanta etj.

Shkalla e mbulimit, që shpreh raportin e numrit të kontribuesve ndaj forcave të punës, ka rënë gradualisht nga 33.76% në 32.41% në periudhën 1994-1999. Më pas ky tregues vjen në rritje, duke arritur në 58.4% në vitin 2012. Ky tregues dëshmon për zvogëlimin e dukurisë së evazionit të kontributeve në skemën e sigurimeve shoqërore. Nëse krahasojmë numrin e të siguruarve me popullsinë në moshë pune situata bëhet akoma më alarmante. Grafiku i mëposhtëm tregon se vetëm 1/3 e popullsisë në moshë pune është e mbuluar nga sistemi i sigurimeve shoqërore, çka do të thotë se aftërsisht 2/3 e shqiptarve që sot janë në moshë pune rrezikojnë të mbeten pa pension në të ardhmen.


Fig. 3 – Numri i kontribuesve krahasuar me popullsinë në moshë pune 2005-2013



Niveli i lartë i papunësisë, punës së zezë dhe mospjesëmarrja në skemë e të vetëpunësuarve në bujqësi do të jetë një barrë sociale shumë e madhe për shoqërinë në vitet e ardhshme, pasi kjo kategori e pasiguar nuk do të ketë të drejtë përfitimi ose përfitime të ulta nga skema e pensionit dhe do t'iu drejtohen skemave të tjera të mbrojtjes shoqërore si ndihma ekonomike, asistencave të ndryshme etj. Këto skema të tjera të mbrojtjes shoqërore financohen nga buxheti i shtetit dhe rritja e numrit të përfituesve do të bëjë të pamundur financimin e tyre.


Treguesi i të ardhurave nga kontributet në skemë paraqitet me rritje të theksuara nga viti në vit. Eshtë për t'u shënuar se në ritmet e shtimit të të ardhurave, një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe reformat parametrike të vitit 2002, si pasojë e rritjes së tavanit të pagës nga trefishi i pagës minimale në pesëfishin e saj. Por, nga ana tjetër, kjo masë ka sjellë si pasojë një disbalancim të përfitimeve, duke qenë se pensioni maksimal vazhdon të mbetet sa dyfishi i pensionit minimal, dhe ka ndikuar mjaft negativisht në lidhjen reale midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve.

Fig. 4 – Të ardhurat dhe shpenzimet e sistemit të pensioneve për vite të përzgjedhura (në mln Lek)



Treguesi i shpenzimeve të skemës së sigurimeve shoqërore ka shënuar të njejtin trend sikurse numri i pensioneve, pra me rritje graduale e normale në vite. Shpenzimet në vitin 2006 ishin 50.2 miliardë lekë, me një rritje prej 4,7 herë ndaj vitit 1994. Rritje e shpejtë e shpenzimeve evidentohet gjatë periudhës 2006-2011 kryesisht si pasojë e rritjes së masës së pensioneve, pasi numri i përfituesve ka pësuar një rritje mjaft normale. Krahasuar me vitin 2005, në vitin 2013, shpenzimet për përfitime janë rritur me mbi 95%, dhe në këtë kontekst, rritjen më të ndjeshme e kanë përfitimet nga pensionet e fshatit, me rreth 134%, ndërkohë që numri i përfituesve është ulur.



Fig. 5 – Rritja e masës së pensionit në zonat urbane dhe rurale (në %)



Siç shihet, gjatë dhjetë viteve të fundit masa e pensionit është rritur shumë më shumë sesa norma e inflacionit, dhe në zonat rurale është rritur me ritme më të larta se në zonat urbane. Kjo rritje e shpenzimeve u shoqërua me një ulje të normës së kontributit, çka rrjedhimisht e thelloi akoma edhe më shumë deficitin e skemës. Nga viti 2005 deri në vitin 2013 deficitin është rritur në mënyrë dramatike me 160%.

Paqëndrueshmëria financiare e skemës. Skema e pensionit në Shqipëri nuk është e balancuar financiarisht. Kjo paqëndrueshmëri financiare është rezultat i rritjes së shpejtë të masës së pensioneëve. Shkaqe të tjera janë numri i ulët i kontribuesve, mosdeklarimi pagës reale, numri relativisht i lartë pensionistëve krahasuar me moshën e re të popullsisë, moshën e ulët e pensionistëve si rezultat i daljes së parakohëhme në pension në fillim të vitëve 90 dhe moshën e ulët e daljes në pension për disa kategori të veçanta, ndryshimet demografike, niveli i papunësisë dhe niveli i lartë i emigracionit i forcave të punës. Në vitin 2013, deficitin mes të ardhurave nga kontributet dhe shpenzimeve për përfitime ka qenë rreth 26.8 mln Lek. Deficitin është shumë më i madh, rreth 42.5 mln Lek, nëse marrim në konsideratë shpenzimet totale të skemës ku përveç shpenzimeve për përfitime përfshihen edhe shpenzimet për skemat suplementare, programet e veçanta qeveritare si edhe shpenzimet administrative. Ky deficit e ka vënë në rrezik qëndrueshmërinë financiare të sistemit të pensioneëve.

Niveli i lartë i rishpërndarjes. Rritja e shumë e lartë e masës së pensionit, e përqëndruar kryesisht në rritjen e pensionit minimal, si edhe ekzistenca e pensionit maksimal kanë bërë që masa e pensionit minimal të jetë thuhetse e barabartë me masën e pensionit mesatar. Megjithatë sistemi është i projektuar dhe funksionon mbi bazën e solidaritetit midis brezave niveli i rishpërndarjes së të ardhurave është shumë i lartë dhe kategori të caktuara përfitojnë ndjeshëm më shumë se kontributet e paguara. Ky fenomen ilustron më së miri nga të vetëpunësuarit në bujqësi që pjesa më e madhe e kontributit paguhet nga buxheti i shtetit si dhe të pensioneëve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, të cilët kontribojnë për 15 vjet dhe përfitojnë një pension për më shumë se 35 vjet.

Fig. 6 – Masa e pensionit në zonat urbane (në Lek)**Fig. 7 – Masa e pensionit në zonat rurale (në Lek)**

Lidhje e dobët midis kontributeve të paguara dhe pensioneve të përfituara. Kufizimi i pensionit maksimal me dyfishin e pensionit minimal bën që të humbasë sasia e kontributeve të paguara dhe tendenca për ta shndërruar pensionin në të sheshtë. Kjo lidhje është e dobët edhe përse i përket periudhës së sigurimit. Nuk ka incentive për të rritur periudhën e sigurimit përtej 35 vjetëve pasi dy kufizimet e masës së pensionit zhvlerësojnë llogaritjen e pensionit sipas formulës, si dhe mungesë incentive për të deklaruar pagat e vërteta për të punësuarit me pagë të lartë.

Të vetëpunësuarit në bujqësi, për shkak të formulës së llogaritjes së pensionit, për të përfituar pension të plotë pleqërie urban iu duhen 35 vjet sigurim, nga të cilat vetëm gjysma (17.5 vjet) duhet të jetë realizuar pas vitit 1993 si kontribut i paguar ose të jenë vjetërsi pune në shtet. Meqënëse ky kontribut mbledhet praktikisht mbi baza vullnetare (pasi edhe pse është i detyrueshëm nuk mund të “detyrohen” të paguajnë), nuk kanë interes të vazhdojnë kontribuimin përtej plotësimit të kësaj periudhe prej 17.5 vjet.


Shkalla e zëvendësimit, që shpreh raportin midis madhësisë së pensionit mesatar me pagën mesatare, rezultojnë me prirje përkeqësimi sidomos në skemë urbane. Në qytet nga 60,2% që ka qenë në vitin 1994, arriti në 46.3% në vitin 2012. Ndërsa, në fshat kemi një trend tjetër. Deri në vitin 2000 kemi një rënie deri në 15.78% nga 27.34% që ishte në vitin 1994. Më pas kemi një rritje të këtij raporti dhe në vitin 2012, arrin në 41.6%. Në këtë dukuri ka ndikuar ritmi më i lartë i rritjes së pensionit mesatar në fshat ndaj pagës minimale kontributive.

3. PARASHIKIMI AFATGJATË I TREGUESVE TË SISTEMIT AKTUAL TË PENSIONEVE

Skema aktuale e pensioneve, nëse do të vazhdojë kështu siç është, në të ardhmen do të japë përfitime shumë më të ulëta se sot krahasuar pe pagën mesatare, do të vazhdojë të ketë deficite fiskale, dhe, ç'është më e rëndësishmja, një pjesë e mirë e popullsisë nuk do të përfitojnë fare pensione për shkak të mos pjesëmarrjes së popullsisë së sotme në moshë pune në sistemin e pensioneve.

Shqipëria sot ka një popullsi të re, por parashikimet afatgjata tregojnë se në të ardhmen do të ketë një plakje të popullsisë, e cila reflektohet në një rritje të pjesës së popullsisë mbi moshën e pensionit ndaj totalit të popullsisë. Ky tregues rritet pothuaj gjatë gjithë periudhës së parashikimit nga 14.9% në vitin 2012 në 25% në vitin 2031 duke përfunduar në rreth 35.0% në vitin 2080, si në grafikun e mëposhtëm:

Fig. 8 – Projektion i grupmoshave ndaj totalit të popullsisë



Rritja e pjesës që zë popullsia mbi moshën e pensionit ndaj totalit të popullsisë, shoqërohet me një rënie të pjesës që zë popullsia në moshë pune ndaj totalit të popullsisë dhe, gjithashtu me uljen e pjesës që zë popullsia nën moshën 15 vjeç ndaj totalit të popullsisë.

Kjo plakje e popullsisë do të sjellë edhe një rritje të koeficientit të varësisë së të moshuarve, i cili nga 23% në vitin 2012 rritet në 41% në vitin 2030. Më pas ritmi i rritjes gradualizohet, duke shkuar në 56.8% në vitin 2055 dhe merr vlerën më të lartë, 68.9%, në vitin 2080. Një rritje e tillë e koeficientit të varësisë së të moshuarve e bën sistemin aktual të pensioneve financiarisht dhe demografikisht të papërbalueshëm në rast se do të vazhdojë të japë përfitime në një raport të ngjashëm me pagën mesatare si sot dhe në rast se do t'u japë përfitime të gjithë të moshuarve.

Fig. 9 – Proj. i koeficientit të varësisë së të moshuarve





Fig. 10 – Proj. i nr të pensionistëve ndaj popullsisë



Numri i pensionistëve ndaj numrit total të popullsisë do të rritet gradualisht nga 19.1% në vitin bazë në 28.3% në vitin 2040. Më pas, ky raport parashikohet që të ketë një ulje të lehtë deri në 24.2% në vitin 2080 duke kapur kështu në vitin e fundit të periudhës së parashikimit nivelin e vitit 2024 pavarësisht se përqindja e të moshuarve ndaj totalit të popullsisë thuhet trefishohet. Kjo ulje reflekton uljen e numrit të kontribuesve e rrjedhimisht edhe uljen e numrit të të moshuarve që kanë të drejtën e përfitimit të një pensioni.

Shkalla e mbulimit të të punësuarve, e cila përfaqësohet nga raporti kontribues mbi të punësuarit, mbetet thuhet konstante gjatë gjithë periudhës së parashikimit. Ajo nis me 55.7% në vitin 2012 dhe mbetet mes 54% dhe 56% deri në vitin 2080.

Fig. 11 – Proj. i shkallës së mbulimit të të punësuarve






Fig. 12 – Proj. i normës së varësisë së sistemit



Norma e varësisë së sistemit (NVS), që shpreh raportin mes kontribuesve dhe përfituesve, do të rritet nga rreth 86 pensionistë për 100 kontribues në vitin bazë në rreth 120 pensionistë për 100 kontribues në vitin 2032 e më pas do të mbetet mbi këtë nivel deri në fund të periudhës së parashikimit, duke shënuar një rënie të lehtë në vitin 2080 ku ky raport do të jetë 118 pensionistë për 100 kontribues. Kjo vjen si rezultat i rritjes me një ritëm më të shpejtë të numrit të pensionistëve se sa kontribuesve.

Shkalla e zëvendësimit, që shpreh raportin mes pagës mbi të cilën janë derdhur kontributet dhe masës së pensionit, ulet në mënyrë drastike nga 36% në vitin 2012 në 20% në vitin 2046, duke përfunduar në vetëm 6.2% në vitin 2080.

Fig. 13 – Projektion i shkallës së zëvendësimit



Kjo rënie që shkaktohet nga indeksimi i pensionit bazë vetëm sipas inflacionit dhe kufizimit të pensionit maksimal në dyfishin e pensionit minimal i cili indeksohet gjithashtu sipas inflacionit, tregon se edhe pensioni maksimal është i lidhur me inflacionin. Si rrjedhim, lidhja mes kontributeve edhe benefiteve, ndonëse shumë e dobët aktualisht, do të vazhdojë të dobësohet edhe më shumë.

Për shkak të rritjes së numrit të pensionistëve dhe rënies së numrit të popullsisë në moshë pune, treguesit financiare të skemës së pensioneve do të vazhdojnë të përkeqësohen deri në vitin 2030. Në këtë vit deficit i skemës nis e reduktohet duke arritur aftëri zero në fund të periudhës së parashikimit duke qenë se numri i përfituesve ulet dhe masa e përfitimit kufizohet gjithnjë e më shumë nga pensioni tavan.

Fig. 14 – Proj. i të ardhurave dhe shpenzimeve





Fig. 15 – Proj. i balancës së skemës (% e PBB)



Në terma afat-shkurtëra, ndonëse rriten gradualisht, ritmi i rritjes së shpenzimeve është shumë më i lartë se ritmi i rritjes së të ardhurave duke e bërë skemën edhe më të paqëndrueshme nga ana financiare. Si rrjedhim, deficit i skemës së pensioneve do të vazhdojë të thellohet duke arritur pikën kulmore në vitin 2029 me 2.3% të PPB-së. Më pas deficit i nis e reduktohet gradualisht duke arritur vlerën e vitit bazë në vitin 2035.

4. OPSIONET E PROPOZUARA PËR REFORMIMIN E SISTEMIT TË PENSIONEVE

1). Përmirësimi i parametrave të sistemit aktual

Një reformë e tillë forcon parimin kontributiv të sistemit aktual dhe e redukton disi shkallën e lartë të rishpërndarjes që e karakterizon atë, duke u dhënë individëve më shumë shtysa për të qenë pjesë e sistemit të sigurimeve shoqërore si edhe për të kontribuar më shumë duke deklaruar pagën reale. Nga ana tjetër, ky opsion parashikon edhe një pension social për të gjitha ata të moshuar të së ardhmes që nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e një pensioni. Në skemën e reformuar pensioni bazë do të zëvendësohet me pensionin social. Veç kësaj, do të hiqet kufizimi i pensionit maksimal deri në dyfishin e pensionit minimal si edhe do të hiqet llogaritja me 75% e pagës neto. Gjithashtu, reforma synon të zhdukë diferencën mes pensioneve rurale e urbane dhe nuk ofron më privilegje të veçanta për fermerët por i përfshin ata në skemën e vetme të vendit. Realizimi i kësaj reforme kërkon marrjen e masave të mëposhtme:

- Ndryshimi i formulës së llogaritjes së pensionit në:

$$P = PS + Sh$$


- **P** është masa e pensionit mujor;
 - **PS** është pensioni social, masa e të cilit është jo më e lartë se sa masa e pensionit të pjesshëm që arrihet nga skema kontributive;
 - **Sh** është shtesa vlera e së cilës është 1% e vlerës së bazës së vlerësueshme për çdo vit, e cila përfaqëson raportin e kontributeve mesatare në vitin aktual me kontributet mesatare të viteve të mëparshme.
- Rregulla të sakta e strikte për indeksimin e masës së pensionit, duke parashikuar vetëm indeksim me inflacionin.
 - Heqja e tavanit të pensionit maksimal.
 - Njehësimi i pagës minimale kontributive me pagën minimale zyrtare dhe indeksimi i pagës maksimale kontributive me rritjen e pagës mesatare.
 - Rritja e viteve të kontributit për sigurimin shoqëror nga 35 në 40 vjet deri në vitin 2025.
 - Rritja graduale e moshës së daljes në pension për gratë me dy muaj në vit, për të arritur në 63 vjeç në vitin 2032. Që nga viti 2032 mosha e daljes në pension për burrat do të rritet me një muaj në vit dhe për gratë me dy muaj në vit duke arritur në 67 vjeç për të dy sekset në vitin 2056.
 - Heqja e privilegjeve për njohjen e periudhave të sigurimit pa paguar kontribute për gratë, siç është njohja e viteve të studimit si vite të siguruar.

- Përmirësimi i mënyrë së llogaritjes së pensioneve për nënat me shumë fëmijë dhe pensionet familjare duke përcaktuar si moshë për përfitimin e pensionit nga bashkëshortët, moshën e daljes në pension.
 - Rritja e normës së kontributit për zonat rurale duke barazuar kontributet e fermerëve me ato të zonave urbane deri në vitin 2017.
 - Përmirësimi i formulës së pensioneve të zonave rurale. Sot, një fermer që ka mbi 17 vjet e gjashtë muaj sigurime në shtet ose si i vetëpunësuar, përfshi edhe sigurimet në kooperative, përfiton pension shteti. Kjo periudhë sigurimi do të rritet gradualisht (1 vit në vit) deri në shuarjen tërësore të njohjes së periudhës si ish kooperativist.
 - Vendosja e elementeve dekurajuese për dalje në pension të parakohshëm dhe inkurajimi i daljes vonë në pension.
 - Pensionistët aktualë do të vazhdojnë të përfitojnë pensionin ashtu si në të shkuarën dhe masa e pensionit do të rritet çdo vit ashtu siç e parashikon ligji, në përputhje me inflacionin.
- ❖ Të gjithë individët që nuk plotësojnë kushtet e nevojshme për përfitimin e një pensioni do të përfitojnë një **pension social**, i cili mund të përfitohet vetëm nga individët mbi 70 vjeç që kanë qenë rezident në Shqipëri gjatë 5 viteve të fundit. Masa e këtij pensioni do të jetë jo më e madhe sesa masa e pensionit të pjesshëm që arrihet nga skema kontributive. Ky pension do të jepet duke patur si kusht verifikimin e të ardhurave dhe do të financohet nga buxheti i shtetit.
- ❖ **Pensionet suplementare shtetërore** për funksionarët politikë, profesorët, ushtarakët etj do të rishikohen me synim lidhjen më të mirë mes kontributit dhe përfitimit dhe uljen e subvencioneve nga shteti. Reforma do të synojë rritjen e moshës së daljes në pension (funksionarët politikë e kanë 55 vjeç), rritjen e normës së kontributit si edhe ndryshimin e formulës së llogaritjes së përfitimeve (shembull: sot një deputet apo ministër, për x lek që derdh si kontribut merr 47x lek si përfitim – formula do të ndryshohet në mënyrë që të përfitojnë 10x më shumë e jo 47x më shumë).
- ❖ **Skemat profesionale** për profesionet e vështira do të kthehen në detyrim ligjor dhe do të përfshijnë disa kategori si punonjësit e industrisë minerare, punonjësit e industrive të tjera si nafta dhe metalurgjia, punonjësit e artit dhe kulturës etj. Këto skema do të kenë si synim garantimin e të ardhurave për individët që dalin në pension më herët sesa mosha zyrtare e daljes në pension. Ato do të jenë kontributive, ku masa e kontributit do të ndahet mes punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe do të krijohen mbi bazën e marrveshjeve kolektive. Mbikqyrja e këtyre skemave do të bëhet nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

- ❖ **Fondet private të pensioneve** do vazhdojnë të bazohen në vullnetin e lirë të qytetarëve për të kontribuar në to. Gjithsesi do të merren disa masa për përmirësimin e performancës së këtyre fondeve. Së pari, duhen ofruar disa lehtësira fiskale. Sot, këto fonde taten dy herë pasi taten edhe kontributi edhe përfitimi, ndërkohë që duhet të taten vetëm përfitimet.

Ky opsion garanton mbajtjen e përfitimeve në nivel normal duke sjellë një përmirësim të ndjeshëm të shkallës së zëvendësimit krahasuar me skemën aktuale. Në skemën aktuale shkalla e zëvendësimit qendron mbi 30% deri në vitin 2032 e më pas fillon të bjerë në mënyrë dramatike, duke shkuar në 25% në vitin 2039, 18% në vitin 2050 dhe vetëm 6.2% në vitin 2080. Nga ana tjetër, reforma që parashikon ky opsion mundëson që shkalla e zëvendësimit të mos bjerë asnjëherë më poshtë se 30%. Në vitin e parë të veprimit, skema e reformuar jep një shkallë zëvendësimi prej 36.4%. Më pas vërehet një rënie graduale, duke qëndruar në rreth 30% nga viti 2025 deri në vitin 2057. Nga kjo pikë ky tregues fillon të rritet ngadalë duke arritur në 31% në vitin 2080. Ndonëse ky pension nuk është shumë gjeneroz, ai do t'i mbajë të moshuarit mbi nivelin e varfërisë e do të jetë edhe financiarisht i përballueshëm. Ata që dëshirojnë të ardhura shtesë do duhet të kursejnë më shumë.

Fig. 16 – Projektion i shkallës së zëvendësimit nën skemën aktuale dhe Opsionin 1




Treguesit financiarë të skemës shënojnë një përmirësim të ndjeshëm nën Opsionin 1 krahasuar me projektionet e skemës aktuale. Heqja e pensionit maksimal dhe forcimi i lidhjes mes kontributeve dhe benefiteve mund ta bëjë skemën e re më tërheqëse për qytetarët duke i nxitur ata që të bëhen pjesë e skemës si edhe që të kontribuojnë në bazë të pagës reale, çka do të sillte një rritje të menjëhershme të të ardhurave. Por, edhe pa këto përmirësime, rritja e pagës minimale kontributive dhe indeksimi i pagës maksimale kontributive me rritjen e pagës mesatare sjell një rritje të mjaftueshme të të ardhurave për të përballuar rritjen e përfitimeve. Vlen të theksohet se si pasojë e njehësimit të kontributeve të skemës rurale me normën më të lartë të

kontribuesve të skemës urbane, ekziston mundësia që një pjesë e kontribuesve në skemën rurale mund të mos kontribuojnë më fare. Gjithsesi, ndërkohë që vendi vazhdon të urbanizohet, numri i kontribuesve ruralë do të vazhdojë të ulet dhe moskontribuimi do të ketë shumë pak ndikim mbi balancën financiare të skemës së propozuar. Individët që do të zgjedhin të mos kontribuojnë do të kenë më shumë të ardhura gjatë viteve të punës dhe kur të plaken do të përfitojnë pensionin social.

Kësisoj, nëse me skemën aktuale hendeku mes të ardhurave dhe shpenzimeve zgjerohet duke e bërë skemën financiarisht të paqëndrueshme në afatshkurtër, në skemën e propozuar nën Opsionin 1 të ardhurat dhe shpenzimet rriten me të njëjtin ritëm duke sjellë një reduktim gradual të deficitit të skemës. Madje, për periudhën 2043-2057 skema kalon në sufiçit. Pas këtij viti deficitit nis e thellohet sërish por mbetet, gjithsesi, në nivele të pranueshme, afërsisht 0.5% të PBB.

Fig. 17 – Projektion i të ardhurave, shpenzimeve dhe deficitit (% e PBB) nën Opsionin 1




Krahasuar me skemën aktuale, skema e propozuar në Opsionin 1 karakterizohet nga një rritje më e shpejtë e numrit të kontribuesve, nga rritja e pagës minimale kontributive që në vitin e parë të reformës si edhe nga rritja graduale e moshës së daljes në pension e cila ul numrin e pensionistëve të rinj – të gjitha këto sjellin një reduktim të menjëherëshëm të deficitit të skemës. Deficiti është matur si diferencë mes të ardhurave nga kontributet dhe shpenzimeve totale dhe nuk përfshin koston e pensionit social. Kështu, më skemën aktuale deficitit mbetet mbi 2% e PBB deri në vitin 2035 duke arritur pikën kulmore në vitin 2027 me 2.3% të PBB-së. Pas vitit 2027, deficitit nis e ulet gradualisht duke arritur në 1.5% të PBB në vitin 2041, në 1% të PBB në vitin 2046 dhe mbetet nën 0.5% të PBB nga viti 2062 deri në vitin 2080.

Përkundrazi, skema e propozuar nën opsionin 1 sjell një reduktim shumë më të shpejtë të deficitit. Nga 1.6% i PBB-së në vitin 2015 deficitit zbritet në 1% në vitin 2018. Reduktimi i deficitit vazhdon edhe për vitet në vijim duke arritur në 0.4% të PBB-së në vitin 2030 dhe në 0% të PBB-së në vitin 2043. Pas këtij viti, skema kalon në sufiçit deri në vitin 2057. Nga ky vit e në vazhdim, për shkak të përfundimit të reformës për rritjen e moshës së pensionit, fillimit të uljes së numrit të kontribuesve dhe masave të larta të pensionistëve të rinj që kanë hyrë në skemë duke kontribuar me paga më të larta, deficitit nis e rritet sërish, duke mbetur në nivele normale nga viti

2059 derri në vitin 2080. Për më tepër, shpenzimet shtesë të qeverisë për të mbuluar kontributet e skemës rurale dhe për kompensimet do të ulen në mënyrë graduale duke qenë se kompensimet do të përfshihen në pensionin social, ndërkohë që edhe shpenzimet për pensionet suplementare do të reduktohen. Këto masa do të sjellin një reduktim të mëtjeshëm të kostove të qeverisë.

Fig. 18 – Projektion i balancës (% e PBB) nën skemën aktuale dhe Opsionin 1



Nën këtë opsjon përmirësohen edhe disa tregues të tjerë të skemës së pensioneve. Kështu, reforma sjell një ulje të pjesës së popullsisë mbi moshën e pensionit ndaj totalit të popullsisë, e cila vjen si rezultat i rritjes së moshës së daljes në pension. Në qoftë se me skemën aktuale ky tregues arrin në 35% në vitin 2080, sipas këtij opsioni në vitin 2080 arrin në 29%. Ulja e numrit të pensionistëve shoqërohet me rritjen e pjesës që zë popullsia nga mosha 15 vjeç deri në moshën e pensionit ndaj totalit të popullsisë, e cila nga 50.7% në skemën aktuale në vitin 2080 do të shkojë në 56%. Veç kësaj, reforma sjell një ulje të koeficientit të varësisë së të moshuarve, i cili në projektionet e skemës aktuale merrte vlerën 69% në vitin 2080 ndërsa nën këtë opsjon në vitin e fundit të parashikimit merr vlerën 52.3%.


Norma e varësisë së sistemit (NVS) për të gjithë pensionistët e pleqërisë nga 62 pensionistë për 100 kontribues në vitin e parë të reformës arrin vlerën rreth 66.8 pensionistë për 100 kontribues në vitin 2034. Kjo vjen si rezultat i rritjes me një ritëm pak më të shpejtë të numrit të pensionistëve se sa kontribuesve, por në se në projektionet e skemës aktuale ky raport ndryshonte me 18% gjatë periudhës së parë të parashikimit, në këtë opsjon rritja është vetëm me 5.6%. Më pas ka tendencë në ulje duke arritur në 55.7 pensionistë për 100 kontribues në vitin e fundit të parashikimit, meqenëse gjatë kësaj periudhe numri i kontribuesve rritet me ritme më të shpejta se numri i përfituesve. Përmirësimi nën opsionin 1 është më se i dukshëm pasi në projektionet e skemës aktuale norma e varësisë është 118 pensionistë për 100 kontribues në vitin 2080.

Shkalla e mbulimit të të punësuarve, e cila përfaqësohet nga raporti kontribues mbi të punësuarit shënon rritje gjatë periudhës së parashikimit. Ky tregues, nga 59.2% në vitin e parë të reformës shkon në 91.2% në vitin e fundit të parashikimit. Krahasuar me skemën aktuale ku fillon me 55.7% në vitin bazë dhe shkon në vetëm 56.7% në vitin e fundit të parashikimit, ky tregues ka një përmirësim të ndjeshëm.

Për të parë nëse ky opsion do të ishte i qëndrueshëm pavarësisht rrethanave është e nevojshme që të testohet edhe në një variant pesimist ku të gjithë variablat mbeten të pandryshuar përveç njërit, që është numri i kontribuesve. Nëse në versionin e mësipërm është bërë një rritje të numrit të kontribuesve për shkak të bërjes së skemës më tërheqëse dhe forcimit të kapaciteteve për të mbledhur kontributet, në variantin e mëposhtëm, të cilin do ta quajmë pesimist, numri i kontribuesve mbetet i pandryshuar gjatë gjithë periudhës së parashikimit.

Siç mund të shihet nga grafiku i mëposhtëm, rritja e numrit të kontribuesve luan një rol shumë të rëndësishëm në performancën e skemës së propozuar nën Opsionin 1. Sidoqoftë, edhe në këtë version pesimist të Opsionit 1 vërehet një përmirësim i ndjeshëm i deficitit krahasuar me skemën aktuale për periudhën 2015-2054.

Fig. 19 – Projektion i balancës (% e PBB) nën skemën aktuale, Opsionin 1 dhe Opsionin 1-Pesimist



Kështu, nëse në skemën aktuale deficitit rritet nga 2% e PBB në vitin 2015 në 2.4% të PBB në vitin 2029, në versionin pesimist të Opsionit 1 deficitit bie menjëherë nga 2% i PBB në vitin 2015 në afërsisht 1.5% të PBB nga viti 2024. Që nga ky vit deri më 2054 deficitit vazhdon të reduktohet në mënyrë drastike duke rënë në 1% të PBB në vitin 2044. Pas vitit 2054 skema aktuale ka një performancë shumë më të mirë sesa Opsioni 1 në versionin pesimist për arsye se Opsioni 1 ofron pensione më të larta.

Mbi numrin e përfituesve dhe koston e pensionit social për periudhën 2015-2080

Kushtet e përcaktuara për t'u kualifikuar për përfitimin e një pensioni social

Përfitues të pensionit social do të jenë ata individë, të cilët:

- Janë rezidentë në Shqipëri e kanë qenë të tillë për pesë vitet e fundit para daljes në pension;
- Kanë mbushur moshën 70 vjeç;
- Nuk kanë të ardhura të tjera.

Kategoritë që mund të jenë përfituesit e pensionit social

Përfituesit e mundshëm të pensionit social do të jenë kategoritë e mëposhtme:

- 1). Individët e kthyer nga emigracioni që nuk kanë një historik të mjaftueshëm pune për të përfituar një pension nga skema e detyrueshme;
- 2). Individë me burime të pakta të të ardhurave, kryesisht banorë të zonave rurale që kanë qenë të vetëpunësuar në bujqësi, por që zotërojnë sipërfaqe të kufizuar toke e nuk mund ta shfrytëzojnë në moshën e pleqërisë;
- 3). Individë të cilët për shkak të gjendjes së mirë ekonomike nuk kanë punuar kur kanë qenë në moshë pune duke mos plotësuar kushtet për përfitimin e një pensioni nga skema e detyrueshme dhe që në pleqëri për arsye të ndryshme kanë pësuar një përkeqësim të gjendjes ekonomike;
- 4). Të papunët afatgjatë ose personat e dekurajuar që s'kanë punuar fare gjatë gjithë jetës së tyre ose që nuk kanë mjaftueshëm vite të siguruara për të përfituar një pension nga skema e detyrueshme;
- 5). Individë të tjerë, kryesisht gra të angazhuara në veprimtari familjare.

Kosto e mundshme e pensionive sociale

Duke qenë se pothuajse të gjithë individët e lindur ne periudhën 1945 deri në vitin 1961 e kanë plotësuar një periudhë minimale sigurimi prej 15 vjetësh për shkak të punësimit të plotë gjatë regjimit totalitar, atëherë mund të arrihet në përfundimin se deri në vitin 2030 numri i përfituesve të pensionit social do të jetë shumë i ulët.

	2015	2016	2017	2020	2030	2040	2050	2060	2070	2080
Nr i përfituesve të pensionit social (në 000)										
varianti optimist	4.9	5.3	6.0	7.3	12.1	30.5	46.4	73.1	116.1	125.0
varianti pesimist	4.9	5.3	6.0	7.7	20.2	55.2	88.2	138.5	211.1	226.4
Masa vjetore e pensionit social (000 ALL)	79.8	82.0	84.4	92.3	124.0	166.7	224.0	292.3	374.2	479.0
Kosto e pensionit social (milione ALL)										
varianti optimist	390.1	436.9	503.8	672.4	1,501.8	5,075.1	10,382.1	21,372.3	43,445.1	59,899.0
varianti pesimist	390.1	436.9	506.5	711.1	2,500.5	9,202.2	19,748.5	40,484.3	79,011.6	108,436.7
Kosto e pensionit social/ PBB										
varianti optimist	0.025%	0.026%	0.028%	0.030%	0.033%	0.056%	0.059%	0.070%	0.083%	0.069%
varianti pesimist	0.025%	0.026%	0.028%	0.032%	0.055%	0.102%	0.113%	0.133%	0.150%	0.125%

Në këtë mënyrë, bazuar në disa supozime të mbështetura në konceptet e sipërpërmendura, janë bërë llogaritjet e numrit të përfituesve si edhe kostot e pensionit social deri në vitin 2080.

Në vitin 2015, supozohet se përfitues të pensionit social do të jenë rreth 4900 vetë dhe shpenzimet për këtë pension do të jenë rreth 390 milionë Lek, ose 0.02% e PPB. Me daljen në pension e të gjithë individëve që kanë histori kontributive gjatë periudhës së komunizmit, do të rritet edhe numri i përfituesve të pensionit social. Kështu, në vitin 2030 përfituesit e pensionit social do të jenë rreth 12000 individë dhe shpenzimet do të shkojnë në rreth 0.03% të PBB. Në vitin 2080, numri i përfituesve do të jetë rreth 125000 individë dhe kosto rreth 0.07% e PBB.

Në variantin pesimist, ku numri i kontribuesve nuk rritet, numri i përfituesve të pensionit social është shumë më i lartë. Sidoqoftë, në dy dekadat e ardhshme numri i përfituesve do të jetë relativisht i ulët pasi të gjithë ata që plotësojnë kriterin e moshës për përfitimin e pensionit social e kanë historinë e nevojshme kontributive për përfitimin e një pensioni nga skema e detyrueshme. Diferenca vërehet në vitin 2030, ku në variantin pesimist numri i përfituesve është rreth 20000 dhe shpenzimet shkojnë në 0.05% të PBB. Në vitin 2070, numri i përfituesve supozohet të shkojë në rreth 211000 individë dhe kosto të jetë në mbi 0.12% të PBB.

2). Reformimi paradigmatic duke lëvizur drejt sistemit me llogari nacionale

Ky opsion propozon reformin rrënjësor të skemës aktuale duke lëvizur drejt sistemit me llogari nacionale. Ky sistem funksionon sipas parimit Pay-As-You-Go, njësoj si skema aktuale, çka do të thotë se kontributet aktuale përdoren për të përballuar shpenzimet për përfitimet aktuale. Sidoqoftë, sistemi nucional paraqet një ndryshim thelbësor krahasuar me sistemin aktual. Kjo sepse ky sistem është dizenuar për të imituar një sistem privat me kontribute të përcaktuara ku masa e pensionit përcaktohet nga historia e kontributeve të individit dhe norma e fitimit të tyre,

vetëm se në këtë sistem norma e fitimit nga kontributet është nocionale, e përcaktuar nga qeveria, dhe jo produkt i investimit të tyre në tregjet financiare. Realizimi i kësaj reforme kërkon marrjen e masave të mëposhtme:


- **Ndryshimi i formulës së llogaritjes së masës së pensionit:** Në një sistem të llogarive nocionale, kontributet mujore regjistrohen dhe atyre iu caktohet një normë interesi. Norma e interesit lidhet me rritjen e pagave në shkallë vendi. Kështu, formula e llogaritjes së pensionit do të ishte:

$$P = \frac{Ka + F}{Jm}$$

- **P** është masa e pensionit;
 - **Ka** është shuma agregate e kapitalit të akumuluar gjatë gjithë viteve kur janë derdhur kontribute;
 - **F** është fitimi nocional i akumuluar gjatë viteve si rezultat i aplikimit të normës nocionale të interesit;
 - **Jm** është jetëgjatësia mesatare e popullsisë në moshën e daljes në pension.
 - Pra, në momentin e daljes në pension, shuma agregate e kapitalit të akumuluar dhe fitimet “nocionale” pjestohen me jetëgjatësinë mesatare dhe kthehen në një pension vjetor, i cili më pas konvertohet në pensione mujore.
- Përfshirja e detyrueshme në këtë skemë e të gjithë personave që kanë lindur pas datës 01/01/1978 ose që kanë hyrë për herë të parë në tregun e punës pas datës 01/01/1994.
 - Të gjithë personat që kanë hyrë në tregun e punës para kësaj date, do të vazhdojnë të jenë pjesë e sistemit aktual të pensioneve, por të reformuar sipas propozimeve të bëra në opsionin e parë.
 - Vendosja e një pensioni social për të gjithë ata që nuk kanë kontribuar mjaftueshëm sa për të marrë një pension nga sistemi nocional. Ky pension do t’u jepet të gjithë personave mbi 70 vjeç që 5 vitet e fundit kanë qenë rezidentë në Shqipëri. Ai do të ketë si kusht tjetër verifikimin e të ardhurave dhe do të financohet nga buxheti i shtetit.
 - Pensionet suplementare shtetërore, skemat profesionale për profesionet e vështira dhe fondet private të pensioneve do të reformohen sipas rekomandimeve të bëra në opsionin e parë.

Ky opsion i ndan përfituesit në tre kategori. Në kategorinë e parë që përfaqësohet në grafik nga vija blu përfshihen pensionistë aktualë, pra ata që kanë dalë në pension para se të hynte në fuqi reforma. Numri i tyre bie në mënyrë drastike nga 415 mijë në vitin 2015 në rreth 100 mijë në vitin 2034 dhe pastaj shkon afër zeros rreth vitit 2055. Në kategorinë e dytë, e cila në grafik përfaqësohet nga vija e kuqe, përfshihen kontribuesit aktualë që kanë hyrë për herë të parë në tregun e punës para vitit 1994 dhe që do të jenë pjesë e sistemit aktual të reformuar sipas Opsionit 1. Numri i tyre rritet gradualisht duke arritur kulmin në vitin 2034 me 218 mijë e pastaj fillon e ulet gradualisht duke u bërë zero rreth vitit 2075.


Fig. 20 – Projektion i numrit të përfituesve të pensionit të pleqërisë



Kategoria e tretë, e cila në grafik përfaqësohet nga vija e gjelbër, përfshin ata individë që janë pjesë e sistemit të propozuar nën Opsionin 2. Numri i tyre rritet gradualisht në 200 mijë në periudhën 2017-2036 dhe arrin kulmin në vitin 2068 me rreth 450 mijë përfitues.


Opsioni 2, ashtu si Opsioni 1, garanton përfitime më të larta sesa skema aktuale pas vitit 2035. Në grafikun e mëposhtëm shohim se norma e zëvendësimit për pensionistët nën skemën aktuale do të ulet shumë shpejt në 30% në vitin 2031 dhe nën 20% pas vitit 2045. Opsioni 2 garanton një normë zëvendësimi që mbetet mbi 30% dhe në disa raste edhe më të lartë sesa Opsioni 1. Sistemi i llogarive nocionale, Opsioni 2, në vitin 2017 jep një normë zëvendësimi rreth 35%. Më pas ajo bie shumë ngadalë në 30% në vitin 2035 dhe mbetet mes 30% dhe 35% deri në fund të periudhës së parashikimit.

Fig. 21 – Projektion i normës së zëvendësimit nën skemën aktuale dhe Opsionet 1 dhe 2



Treguesit financiarë nën Opsionin 2 përmirësohen ndjeshëm krahasuar me skemën aktuale. Kështu, nën skemën aktuale deficitin, i cili përfaqëson diferencën mes të ardhurave nga kontributet dhe shpenzimeve totale dhe nuk përfshin koston e pensionit social, thellohet nga 2.2% i PBB në afërsisht 2.4% të PBB në vitin 2027. Më pas nis e reduktohet gradualisht duke u ulur në 1.5% të PBB në vitin 2041, në 1% të PBB në vitin 2046 dhe mbetet në 0.5% të PBB pas vitit 2064.

Fig. 22 – Projektion i deficitit (% e PBB) nën skemën aktuale dhe Opsionin 2




Nën Opsionin 2, deficitin bie menjëherë nga 1.6% i PBB në vitin 2015 në 1% të PBB në 2018. Rënia graduale e deficitit vazhdon edhe për periudhën e mbetur duke rënë nën 0.5% të PBB për periudhën 2037-2074, vit në të cilin sistemi kalon në sufit.

Treguesit e tjerë të skemës, si norma e varësisë së sistemit dhe shkalla e mbulimit të të punësuarve përmirësohen njësoj si në Opsionin 1, kryesisht për shkak të rritjes së moshës së daljes në pension dhe bërjes së skemës më tërheqëse për qytetarët.

Në variantin pesimist të Opsionit 2, ku nuk rritet numri total i kontribuesve, vërehet se roli që luan ky tregues nuk është aq i rëndësishëm sa në Opsionin 1. Kështu, edhe në variantin e tij më pesimist, Opsioni 2 sjell një përmirësim të ndjeshëm të deficitit krahasuar me skemën aktuale, e madje pas vitit 2052 ka një performancë më të mirë se varianti real i Opsionit 2. Gjithsesi, është e rëndësishme që të nënvizohet se ky përmirësim i variantit pesimist të Opsionit 2 vjen vetëm si rezultat i faktit se ai jep përfitime më të ulëta. Kjo për arsye se meqenëse norma nocionale e interesit është e lidhur me rritjen e pagave, kur numri i kontribuesve nuk rritet edhe rritja e pagave është e ulët. Rrjedhimisht, edhe norma nocionale e interesit do të jetë me e ulët duke shkaktuar një ulje të përfitimeve.

Fig. 23 – Proj. i balancës (% e PBB) nën skemën aktuale, Opsionin 2 dhe Opsionin 2-Pesimist




Në këtë mënyrë, në skemën aktuale deficitin rritet nga 2.2% e PBB në vitin 2015 në 2.4% të PBB në vitin 2027, në versionin pesimist të Opsionit 2 deficitin ulët menjëherë nga 2% e PBB në vitin 2015 në 1% të PBB në vitin 2035. Ulja e deficitit vazhdon edhe për periudhën e mbetur dhe deficitin mbetet nën 0.5% të PBB nga viti 2043 deri në vitin 2071. Pas këtij viti skema kalon në sufit.

5. PËRFUNDIM

Skema aktuale e pensioneve të Shqipërisë vuan nga një deficit i thellë, ofron përfitime të ulëta dhe mbulon një numër të ulët të popullsisë në moshë pune. Projektionet afatgjata tregojnë se nëse kjo skemë nuk reformohet përfitimet do të jenë gjithnjë e më të ulëta krahasuar me pagën mesatare dhe një numër i konsiderueshëm qytetarësh do të mbeten pa penion pleqërie.


Fig. 24 – Projektion i balancës (% e PBB) nën skemën aktuale dhe Opsionet 1 dhe 2



Ky dokument politikash ofron dy opsione për reformë. Opsioni 1 fokusohet në përmirësimin e parametrevave të sistemit aktual. Opsioni 2 propozon një reformë paradigmatiche duke u zhvendosur drejt sistemit me llogari nocionale. Të dy opsionet fokusohen tek forcimi i lidhjes mes kontributeve dhe benefiteve duke i inkurajuar qytetarët që të bëhen pjesë e skemës dhe të kontribuojnë me pagën e tyre reale. Rrjedhimisht, të dy opsionet e propozuara sjellin një reduktim të deficitit si edhe përfitime më të larta për qytetarët. Deri në vitin 2030 të dy opsionet kanë një performancë thuajse të njëjtë në reduktimin e deficitit. Pas këtij viti Opsioni 1 rezulton më efektiv sesa Opsioni 2 në reduktimin e deficitit duke dhënë një deficit që është thuajse 1% të PPB më i ulët në fund të periudhës së parashikimit.

Për të parë nëse këta dy opsione janë të qëndrueshëm, paramtrat e tyre u testuan në një variant pesimist ku të gjithë variablat mbeten të pandryshuara përveç numrit të kontribuesve, i cili është rritur në variantin real dhe është mbajtur i pandryshuar në variantin pesimist. Nga testimi rezulton se edhe në variantin pesimist, në terma afat-mesme, të dy opsionet ofrojnë një përmirësim të deficitit krahasuar me skemën aktuale. Në terma afat-gjata Opsioni 2 ka një performancë më të mirë se skema aktuale dhe Opsioni 1.

Fig. 25 – Proj. i balancës (% e PBB) nën skemën aktuale dhe varianteve pesimiste të Opsioneve 1 dhe 2



Kështu, në variantin e tyre pesimist, nga viti 2015 gjer në vitin 2022, të dy opsionet e reduktojnë thuajse njësoj deficitin. Pas këtij viti, për periudhën 2023-2038, performanca e Opsionit 2 përmirësohet ndjeshëm krahasuar me Opsionin 1. Në Opsionin 2 deficitin zbritet gradualisht në 1% të PBB gjatë kësaj periudhe ndërsa në Opsionin 1 deficitin mbetet mbi 1.5% të PBB duke qenë se Opsioni 1 jep përfitime më të larta. Reduktimi i deficitit në Opsionin 2 vazhdon me ritme të shpejta dhe pas vitit 2044 deficitin mbetet nën 0.5% të PBB, ndërsa në Opsionin 1 deficitin mbetet relativisht i lartë dhe në vitin 2052 ai ka një deficit më të lartë edhe se skema aktuale.

Sistemet e pensioneve synojnë si parandalimin e varfërisë në pleqëri ashtu edhe rënien e menjëhershme të të ardhurave dhe konsumit kur njerëzit kalojnë nga punësimi në pension. Këto dy objektiva përjashtojnë njëri-tjetrin sepse sa më shumë një sistem pensionesh fokusohet mbi reduktimin e varfërisë dhe rishpërndarjen aq më pak të ardhura do të disponohen për t'u garantuar individëve me paga të mesme e të larta një pension më afër të ardhurave të tyre gjatë viteve të punës. Vendet ndryshojnë përse i përket rëndësisë që u japin secilit prej këtyre elementëve pasi disa vende fokusohen vetë mbi reduktimin e varfërisë ndërsa disa të tjera mbi zëvendësimin e të ardhurave gjatë viteve të punës. Në këtë dokument, Opsioni 1 karakterizohet nga një masë e pranueshme rishpërndarjeje duke qenë se të gjithë kontribuesit do të përfitojnë pensionin social në moshën e daljes në pension plus një përqindje të caktuar të pagave të tyre mesatare, ndërsa Opsioni 2 është një skemë e pastër kontributive ku pensioni i çdo kontribuesi varet vetëm nga niveli i kontributeve të derdhura. Sidoqoftë, zgjedhja mes të paturit apo jo rishpërndarje nuk duhet parë si një zgjedhje mes këtyre dy opsioneve. Opsioni 1 mund të bëhet më pak rishpërndarës duke hequr pensionin social apo ulur masën e tij dhe duke forcuar lidhjen mes kontributeve dhe pensionit dhe Opsioni 2 mund të bëhet më shumë rishpërndarës duke i shtuar njëfarë pensioni social përfitimeve totale.

6. SHTOJCA 1: MBI EFEKTET FINANCIARE TË RREGULLIMEVE TË PROPOZUARA NË SKEMAT SUPLEMENTARE, TË TRAJTIMIT FINANCIAR TË TË PUNESUARVE NË RAST SËMUNDJEJE SI EDHE TRAJTIMIN E GRAVE TË SIGURUARA LIDHUR ME PËRFITIMET PËR BARRËLINDJE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore me dispozita të veçanta, është ngarkuar të administrojë dhe paguajë përfitimet që rrjedhin nga disa skema të përfitimeve suplementare dhe trajtimet e veçanta financiare. Gjithshtu në kuadrin e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, personat e siguruar kanë të drejtën e përfitimeve në rastet e sëmundjeve si dhe të barrëlindjes.

Në këtë seksion, evidentohen efektet financiare si pasojë e rregullimeve në parametrat e skemës të sigurimeve shoqërore suplementare si edhe efektet financiare si pasojë e rregullimeve që parashikohen të behën në përlllogaritjen e përfitimeve në rastet kur personat e siguruar janë përkohësisht të paafte për punë ose në rastet e barrëlindjeve të grave të siguruara.

a. Përfitimet suplementare

Skemat e përfitimeve suplementare dhe të trajtimeve të veçanta janë vendosur përgjatë 20 viteve të fundit si pasojë e zbatimit të disa politikave për t'u dhënë mbrojtje të veçantë disa kategorive specifike të personave që kryejnë funksione kushtetuese, që janë të punësuar në institucione të larta të qeverisjes apo në institucione qendrore si dhe personave që kanë tituj të lartë shkencorë dhe kanë punuar në institucione akademike apo në universitete.

Gjithashtu nëpërmjet skemave suplementare u është përcaktuar mbrojtje e detyrueshme me pensione të parakohëshme dhe pensione suplementare ish ushtarakëve, punonjësve të policisë etj. Ndërkohë, si pasojë e mbylljes së minierave dhe të ndërmarjeve të industrisë ushtarake janë vendosur skema të veçanta trajtimi edhe për ish minatorët si edhe për ish-punonjësit e industrisë ushtarake të cilët kanë mbetur të papunë.

Në të gjitha skemat, përfitimet individuale akordohen kur përgjithësisht është plotësuar një moshë e përcaktuar dhe një periudhë shërbimi e përcaktuar. Përlllogaritja e përfitimeve përgjithësisht realizohet bazuar në pagën referuese me të cilën kuptohet paga e fundit e atij funksioni apo grade në momentin kur kërkuesi ka plotësuar kushtet për të fituar një të drejtë si edhe në një përqindje të përcaktuar të pagës mesatare referuese për çdo vit shërbimi të siguruar. Nga sa më sipër kuptohet që kemi të bëjmë me skema suplementare me përfitime të përcaktuara të financuara sipas perimit PAYG. Përveç sa më sipër karakteristika të përbashkëta të skemave suplementare janë:

- i. Vendosja e normave modeste të kontributeve të cilat mbulojnë një pjesë të vogël të përfitimeve krahas financimeve të buxhetit të shtetit të cilat aktualisht mbulojnë mbi 82% të kostos së përfitimeve;

- ii. Ndonëse për disa kategori përfituesish përfitimet janë relativisht të larta pasi shumat mujore të tyre kalojnë ndjeshëm pagën mesatare për punonjësit publikë, keto përfitime ligjërisht nuk janë objekt taksimi;
- iii. Në të gjitha skemat suplementare, megjithëse kontributet e vendosura janë modeste, si periudha shërbimi njihen edhe periudha për të cilat nuk janë paguar kontribute. Ky problem është më i theksuar në skemën e përfitimeve të ish-ushtarakeve si edhe në skemën suplementare për punonjësit me tituj shkencorë;
- iv. Moshat e përfitimit të pensioneve të parakohshme, si për pensionet suplementare shtetërore ashtu edhe për ish-ushtaraket janë shumë të ulëta dhe fillojnë nga mosha 42 deri në 55 vjeç;
- v. Buxheti i shtetit, përveç domosdoshmërisë për financimin e deficitit të skemave, është i ngarkuar me ligj që për kategoritë e përfituesve të pensioneve të parakohshme të mbulojë edhe kontributet për efekt të përfitimit të tyre nga skema e detyrueshme. Nisur nga moshat ligjore të përfitimit periudha maksimale e mbulimit me kontribute arrin deri në 18 vite ndërsa kontributet përlllogariten në bazë të pagës referuese që kishte përfituesi në momentin e ndërprerjes së funksionit apo shërbimit;
- vi. Lidhur me përfituesit evidentohet qartësisht një tendencë në rritje pasi në harkun e 12 viteve numri i tyre është rritur me 2,6 herë ndërkohë që vëllimi i përfitimeve është rritur me 4,3 herë;
- vii. Skema e përfitimeve suplementare të ish-ushtarakëve në 4 vitet e fundit ka pësuar ndryshime thelbësore në funksion të kufizimit të përfitimeve të larta, por megjithatë me kontributet e derdhura aktualisht mbulohen vetëm rreth 75 % të shpenzimeve ndërkohë që pagesa e kontributeve të sigurimit të detyrueshëm mbulohet e gjitha me financim buxhetor.

Shpenzimet, të ardhurat si edhe numri i përfituesve në periudhen 2000-2013 paraqiten si më poshtë:

	2001	2005	2006	2009	2011	2012	2013
Të ardhura	31	80	68	285	641	720	719
Shpenzime	941	1,712	1,946	2,558	4,169	4,256	4,073
Balanca	-911	-1,631	-1,877	-2,274	-3,528	-3,537	-3,354
Numri i përfituesve	10,235	14,840	16,019	16,613	22,170	24,660	26,528

Duke qenë se skema e përfitimeve të ushtarakeve, në kuptim të optimizimit të përfitimeve mund të konsiderohet e ezauruar pasi ndër të tjera është vendosur llogaritja e përfitimeve mbi bazen e pagës referuese neto, skema suplementare për punonjësit e lartë të shtetit si edhe ajo për profesionistët me tituj të lartë shkencorë janë mjaft gjeneroze dhe diktojnë nevojën për reformimin e tyre.

Bazuar në parashikimet e ecures së treguesve të numrit të përfituesve, numrit të kontribuesve si edhe vëllimit të përfitimeve realizuar në funksion të hartimit të treguesve të sistemit të Sigurimeve Shoqërore për buxhetin afatmesëm 2013-2020 evidentohet se numri i përfituesve si dhe shpenzimet për përfitime do të vazhdojnë të rriten duke sjelle si pasojë edhe rritjen e subveconeve shtetërore për mbulimin e pagesave. Në harkun e 7 viteve numri i përfituesve parashikohet të rritet me 16-20% ndërkohë që shpenzimet për përfitime parashikohet të rriten me rreth 56 %, kjo ndër të tjera edhe për shkakun e rritjes së ndjeshme të përfitimit mesatar.

Skema e ndërtuar ka si qëllim dhënien e përfitimeve si të ardhura shpesh mbi përfitimet që jepen nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm për punonjësit që kanë kryer funksione kushtetuese dhe punonjësit e shtetit ndërkohë që burimet e financimit të përfitimeve suplementare janë buxheti i shtetit dhe kontributet suplementare në masën 2-4 % të pagës që paguhen nga personat e punësuar në këto funksione.

Personat që kanë kryer funksione kushtetuese dhe funksionarët e lartë të shtetit, pas ndërprerjes së funksionit kanë të drejtën e një shpërblimi të menjëhershëm me 1 deri në 3 paga mujore (në varësi të funksionit) si dhe të drejtën për trajtimin me pagesa kalimtare në masën 50% të pagës referuese për aq vite sa kanë qenë në funksion por jo më shumë se 3 vjet. Periudha e trajtimit me pagesë kalimtare njihet si periudhë sigurimi për sistemin e detyrueshëm dhe kontributet për këtë periudhë derdhen nga Buxheti i Shtetit.

Personat që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësit e lartë të shtetit kanë të drejtën e përfitimit të pensionit suplementar kur mbushin moshën 55 vjeç. Masa e përfitimit varet nga vitet e shërbimit dhe funksioni që ka patur. Përfitimi mujor, në varësi të funksionit, mund të jetë 25% ose 20% e pagës referuese për 2 vite shërbimi dhe me një shtesë 5% të pagës referuese për çdo vit shërbimi mbi 2 vjet. Këto përfitime kufizohen me 60 ose 50% të pagës sipas rastit dhe janë objekt rivlerësimi sa herë dhe në atë masë që rritet paga referuese e personelit në funksion.

Punonjësit e tjerë të shtetit të cilët janë pjesë e stafit të ministrive dhe institucioneve publike qendrore këtë të drejtë e gëzojnë në moshën 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç për gratë. Pensioni i tyre llogaritet bazuar në periudhën kontributive në ato funksione me një indeks përfitimi për çdo vit i cili varion nga 1.1-1.5% të pagës dhe në bazë të pagës mesatare referuese. Për këta persona përfitimi suplementar nuk mund të jetë më i lartë se 40% e pagës referuese.

Për të gjithë rastet ekziston edhe një kufizim i përgjithshëm ku përcaktohet se masa e pensionit shtetëror suplementar plus pensionin e përfituar nga skema e pensioneve publike nuk mund të jetë më e madhe se 75% e pagës referuese të funksionit.

Mbi bazën e të njejtit parim është ndërtuar edhe skema për përfitimet suplementare të pesonave me tituj të lartë shkencorë por me ndryshimin se masa e kontributit është 3% e pagës për ata që janë të punësuar në universitetet publike dhe 7% të pagës për ata që janë të punësuar në universitetet private. Për ata persona me tituj që punojnë edhe në universitete jopublike masa e përfitimit shkon deri në dyfishin e pensionit nga skema e detyrueshme.

Nga sa më sipër konstatohet se skema e përfitimeve suplementare është mjaft gjeneroze dhe për më tepër përfitohet në mosha që janë deri në 10 vjet më të ulëta se mosha ligjore e daljes në pension. Një pjese e pjesëmarrësve në skemë perfitojnë deri në 400% të kontributeve të paguara.

Punonjësit e institucioneve qendrore duke paguar një kontribut deri në 3% të pagës përfitojnë një pension masa e të cilit shkon deri në 40% të pagës referuese, ndërkohë që kjo shkallë zëvendësimi nuk arrihet as në skemen e detyrueshme ku masa e kontributit për pension është 21.6% e pagës.

Veç kësaj, këto përfitime, edhe pse kalojnë pragun minimal të të ardhurave të pataksueshme, ligjërisht janë të pa taksuara.

Numri i përfituesve do të vazhdojë të jetë gjithnjë e më i lartë duke arritur në mbi 7000 persona në 15 vitet e ardhshme.

Për shkak të zgjatjes së periudhave të shërbimit apo të qëndrimit në funksione të caktuara, përfitimet do të jenë gjithnjë e më të larta ndërkohë që financimi i tyre nga kontributet mund të mbulojë vetëm 20% të shpenzimeve për perfitime duke shtuar barrën e buxhetit të shtetit.

Në këto kushte për përafrimin e të drejtave që personat përfitojnë nga skema të ndryshme, për përmirësim e situatës financiare të tyre dhe për uljen e subveicioneve shtetërore nevojitet që të merren masat e mëposhtme:

- i. Rritja e moshës së përfitimit të pensionit suplementar shtetëror me 5 vite;
- ii. Rritja e normës së kontributeve proporcionalisht për të gjitha funksionet e larta shtetërore duke arritur në 5% të pagës referuese;
- iii. Njehësimi i normës së kontributeve për personat me tituj shkencorë që punojnë në universitetet publike dhe private duke arritur në 5% të pagës referuese;
- iv. Llogaritja e përfitimeve dhe kufizimeve mbi bazën e pagës neto. Paga neto përlllogaritet duke zbritur nga paga referuese TAP dhe kontributitn e Sigurimeve Shoqërore, shëndetsore të detyrueshme dhe suplementare që paguhet nga të ardhurat e personit të siguruar.

- v. Indeksimi i këtyre përfitimeve bazuar në indeksin e pagave për personat e lartë shtetërore, por jo më shumë se sa rritja e indeksit të çmimeve.

Nga sa më sipër, si pasojë e përlogaritjes së përfitimeve bazuar në pagën referuese neto, në momentin e maturimit të këtyre parametrave përfitimet e ardhshme do të jenë rreth 28% më të ulëta se përfitimet aktuale nderkohe që si pasojë e rritjes së kontributit ndaj pagës do arrihet një shtesë e të ardhurave nga kontributet me rreth 2%. Me marrjen e këtyre masave, barra e buxhetit të shtetit për skemat suplementare parashikohet të ulet me mbi 30%.

Opsionet e përcaktuara më sipër për ndryshimin e parametrave të sistemit mbështeten edhe mbi faktin se:

- i. Ndërsa mosha e daljes në pension për të gjithë shqiptarët është rritur me 5 vite dhe është duke u diskutuar një rritje e mëtejshme e saj, mosha e daljes në pension për funksionarët e lartë shtetërorë ka mbetur 55 vjeç;
- ii. Kontributet suplementare për ushtarakët dhe për policinë e shtetit tashmë janë përcaktuar në masën 5% ndërkohë që kontributet suplementare shtetërore janë në nivelet 2-4% të pagës referuese;
- iii. Përfitimet suplementare të ushtarakëve përlogariten bazuar në pagën referuese neto ndërkohë që përfitimet shtetërore përlogariten bazuar në pagën referuese.

Problematikë për t'u zgjidhur mbetet unifikimi i përfitimeve të personave që kanë dalë në pension dhe përfitojnë të ardhura më të larta se ato që mund të përfitohen pas kësaj reforme. Për këtë do të duhet të parashikohen dispozita të veçanta të cilat mund të lidhen me mos indeksimin e përfitimeve ekzistuese për një farë kohe apo nëpërmjet masave të tjera.

b. Mbi ndryshimin e parametrave për llogaritjen e përfitimeve për rastet e sëmundjeve dhe barrëlindjeve.

Sigurimi shoqëror i detyrueshëm, përveç degës së pensioneve, parashikon dhënien e përfitimeve edhe për rastet e paaftësisë së përkohshme në punë për shkak të sëmundjeve si edhe për rastet e barrëlindjeve.

Kushtet e përfitimit dhe përlogaritja e të ardhurave është si më poshtë:

- i. Të ardhurat për sëmundje përfitohen nga personi i siguruar kur vërtetohet me raport mjekësor se ai është përkohësisht i paaftë për të punuar kurse e ardhura mesatare ditore është 70% e mesatares ditore të bazës së vlerësueshme të vitit të fundit kalendarik kur i siguruari ka deri në 10 vjet sigurim dhe 80% kur i siguruari ka mbi 10 vjet sigurim;
- ii. E ardhura për barrëlindje i paguhet gruas së siguruar për barrën dhe lindjen e fëmijes kur ajo ka 12 muaj periudhë sigurimi për çdo rast përfitimi. Periudha e përfitimit është 365

ditë kalendarike duke përfshirë një minimum prej 35 ditësh para dhe 42 ditësh pas lindjes së femijës. E ardhura për barrëlindje për gruan e siguruar është:

- a. 80% e mesatares ditore të bazës së vlerësueshme të vitit të fundit kalendarik për periudhën e paralindjes dhe për 150 ditë kalendarike pas lindjes;
- b. 50% e mesatares ditore të bazës së vlerësueshme të vitit të fundit kalendarik për periudhën tjetër në vazhdim;
- c. E ardhura për barrëlindje për gratë ekonomikisht aktive (gratë e vetpunësuar) është e barabartë me nivelin bazë të pensionit të pleqerisë.

Gjendja aktuale e këtyre skemave paraqitet si vijon:

Në tre-katër vitet e fundit, për shkak të rritjes së moshës për pension dhe rritjes së numrit të grave të siguruar (sidomos në fshat), shpenzimet për sëmundje dhe barrëlindje janë rritur ndjeshëm. Nga ana tjetër, bazuar në treguesit e buxhetit afatmesëm parashikimet lidhur me shpenzimet për këto dy degë paraqiten si më poshtë:

	2,012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Sëmundje	381	410	422	443	465	473	513	543	563
Barrëlindje	2,076	2,335	2,449	2,526	2,607	2,677	2,730	2,743	2,823
Barrëlindje Qytet	1,452	1,664	1,747	1,797	1,850	1,896	1,932	1,896	1,967
Barrëlindje Fshat	520	564	587	609	632	647	660	704	710
Shpërblim Lindje	104	107	115	120	124	134	139	143	146

Sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit aktual të Sigurimeve Shoqërore, periudha e përfitimit të të ardhurave për barrëlindje dhe për sëmundje njihet si periudhe sigurimi për përllogaritjen e pensionit. Në këto raste kontributet zbriten nga të ardhurat e degës së barrëlindjes dhe kalojnë në degën e pensioneve. Aktualisht norma e kontributit ndaj pagës për degën e barrëlindjes është 1.3% ndërsa për sëmundje 0,8%. Gjithashtu, të ardhurat e grumbulluara mbi bazën e këtyre normave të kontributit kanë mbuluar përfitimet e paguara nga këto degë si edhe kontributet e transferuara.

Megjithatë ekzistojnë disa arsye për të ndërhyrë në parametrat e llogaritjes së këtyre përfitimeve:

- i. Në kuadrin e reformës së sistemit të përfitimeve dhe të përmirësimeve të parimit kontributiv parashikohet një rritje e ndjeshme e numrit të kontribuesve e për këtë shkak pritet edhe një rritje e numrit të grave të siguruar për efekt të përfitimit të barrëlindjeve apo edhe të sëmundjeve;
- ii. Efektet e rritjes së vëllimit të përfitimeve evidentohen edhe aktualisht. Në vitin 2020 përfitimet në këto degë parashikohet të rriten me 30% çka do të kërkojë financime më të

larta që do të kërkojnë domosdoshmërisht rritjen e normës së kontributit ose mbulimin me subvecone, gjë që nuk mund të jetë e zakonite kur behët fjalë për përfitime afatshkurtra;

- iii. Si të gjitha përfitimet e tjera që akordohen nga sistemi i Sigurimeve Shoqërore, edhe këto përfitime nuk taksohen. Rrjedhimisht, e gjithë periudha e përfitimit llogaritur me 80% të pagës së vitit të fundit kalendarik, evidenton të ardhura individuale më të larta se në rastet kur përfituesi është në marrëdhënie pune. Në rastin e marrëdhënieve të punës, përfitimet në para, pas zbritjes së tatimit mbi të ardhurat dhe kontributit të sigurimit shoqëror e shëndetsor reflektojnë një shumë të ardhurash që është 75-78% e të ardhurave bruto;
- iv. Gjithë sa u përshkrua më sipër bie ndesh me parimin e sigurimit shoqëror i cili përcakton një shkallë të caktuar të zëvendësimit të të ardhurave të humbura për shkak të sëmundjes apo barrë lindjes;
- v. Edhe gjatë zbatimit të këtyre dispozitave në ndërmarrje apo institucione janë evidentuar tendenca për përfitime jo shumë të argumentuara nga ana shëndetësore dhe ka pasur mjaft ankesa kur këto dispozita janë adoptuar edhe për zbatimin e kodit të punës lidhur me pagesën e raportave të sëmundjeve për 14 ditët e para.

Per zgjidhjen e problemeve të mësipërme nevojitet që për efekt të përlllogaritjes së të ardhurave për barrë lindje dhe sëmundje, paga mesatare e vitit të fundit kalendarik të zëvendësohet me pagën mesatare neto të 12 muajve të fundit kalendarik. Kjo do të bënte që të ardhurat për barrë lindje dhe sëmundje për personat e siguruar të zëvendësojnë të ardhurat neto të tyre në masë 80 dhe 70% respektivisht, ndërkohë që për gratë e vetpunësuarat e ardhura për barrë lindje të mos jetë më e vogël se 65% të pagës minimale neto. Në këto kushte përlllogaritet të ketë mesatarisht një ulje të shpenzimeve me rreth 18-20 % ose rreth 500 milione leke në vit.

Reduktimi i këtyre përfitimeve dhe të shmangë nevojën për rritjen e normës së kontributit ndërkohë që do të zbatohet një zëvendësim më të drejtë të të ardhurave të munguara.

Grupet e prekura nga këto ndryshime janë individët e siguruar si të punësuar që kanë të ardhura më të larta se paga minimale, pasi për të vetëpunësuarit përfitimet për barrë lindje nuk mund të jenë më të vogla se 65% e pagës minimale neto. Megjithatë vlen të theksohet se ndërsa të vetëpunësuarit i paguajnë kontributet për këto degë nga të ardhurat e tyre, kontributet e personave të punësuar ndahen midis tij dhe punëdhënësit në raportin 1:2 dhe një rritje e normës së kontributit do të sillte rrjedhimisht rritjen e kostos së punës.

7. SHTOJCA 2: MBI TË DHËNAT E PËRDORURA DHE SUPOZIMET E BËRA PËR PROJEKSIONET AFATGJATA TË TREGUESVE KRYESORE TË SKEMËS SË PENSIONEVE.

Parashikimet në Skemën e Pensioneve janë realizuar duke përdorur modelin aktuarial afatgjatë PROST dizenuar nga Banka Botërore, i cili përdoret për parashikimet në skemat e pensioneve në mbi 80 vende. Modeli parashikon numrin e popullsisë, numrin e kontribuesve dhe përfituesve në skemë, kontributet e përfitimet e tyre dhe rezultatin përfundimtar financiar të sistemit.

Në Skemën e Pensioneve në Shqipëri ekzistojnë dy nënskema, një urbane dhe një rurale. Ka dallime ndërmjet kontribuesve urbanë dhe ruralë, masave përkatëse të kontributit, pagave mesatare mbi të cilat llogariten kontributet; gjithashtu, ka dallime ndërmjet përfituesve urbanë e ruralë, masave të përfitimeve dhe koeficientit të indeksimit të pensioneve. Për këtë arsye, programi aktuarial afatgjatë PROST operon me dy modele të ndarë nga njëri tjetri, një për pjesën urbane të skemës së pensioneve dhe një për pjesën rurale të saj. Në secilin prej modeleve skema përkatëse trajtohet si e veçantë, dhe më pas programi jep mundësinë e mbledhjes së rezultateve të të dy modeleve.

Parashikimet varen fuqimisht nga supozimet që bëhen për një situatë të caktuar. Rezultatet mund të jenë të ndryshme për bashkësi të ndryshme supozimesh.

Parashikimi është realizuar për periudhën 2012 – 2080, ku 2012 është viti bazë dhe 2080 është viti i fundit i periudhës së parashikimit.

Të dhënat mbi numrin e popullsisë sipas moshës e gjinisë dhe të dhënat mbi shkallën e lindshmërisë e mortalitetit sipas moshës dhe gjinisë deri në vitin 2031 janë bazuar në të dhënat për popullsinë shqiptare, projektuar nga INSTAT bazuar në rezultatet e Censurit 2011. Më pas, deri në vitin 2080, ritmi i ndryshimit të shkallës së lindshmërisë dhe mortalitetit sipas moshës dhe gjinisë, i referohet popullsisë shqiptare projektuar nga Departamenti i Popullsisë pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Të dhënat statistikore të skemës së pensioneve, numri i kontribuesve, paga mesatare mbi të cilën paguhen kontributet, paga minimale kontributive, kontributet e paguara, numri i pensionistëve, masa mesatare e pensionit, masa e pensionit minimal dhe përfitimet e paguara janë marrë nga botimet e ISSH me të dhëna statistikore të vitit 2012.

Të dhënat mbi numrin e kontribuesve urbanë të vitit bazë të detajuara sipas gjinisë dhe moshës, janë marrë nga Regjistri i Numrit të Sigurimit Shoqëror, ndërsa të dhënat mbi numrin e kontribuesve ruralë të vitit bazë të detajuara sipas gjinisë dhe moshës janë marrë nga Baza Elektronike e të Vetëpunësuarve në Bujqësi.

Të dhënat për numrin e pensionistëve të vitit bazë dhe masës së pensionit që ata përfitojnë, të detajuara këto sipas kategorive të pensioneve, gjinisë dhe moshës janë marrë nga Rregjistri i Elektronik i Pensioneve.

Supozimet demografike, të treguesve të punës dhe supozimet makroekonomike janë të njëjta për të dy modelet urbane dhe rurale.

➤ **Supozimet demografike**

Shkalla e lindshmërisë është marrë 1.7 në vitin bazë dhe vjen në ulje deri në 1.5 në vitin 2031. Këto të dhëna i referohen INSTAT-it. Për periudhën 2032 – 2080, ky tregues ndjek ritmin e ndryshimit (sipas moshës) të shkallës së lindshmërisë të popullsisë shqiptare projektuar nga Departamenti i Popullsisë pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në vitin e fundit të periudhës së parashikimit shkalla e lindshmërisë do të jetë 1.9.

Koeficientët e mortalitetit (sipas moshës) janë vënë në dispozicion nga INSTAT deri në vitin 2031. Për periudhën pas vitit 2031, ato ndjekin ritmin e ndryshimit të koeficientëve të mortalitetit të popullsisë shqiptare, projektuar nga Departamenti i Popullsisë pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Jetëgjatësia në lindje për burrat (gratë) nga 75.1 (79.2) në vitin 2012 do të jetë 83.4 (86.4) në vitin e fundit të parashikimit 2080.

Imigracioni është një supozim i rëndësishëm. Të dhënat e vendosura në model janë marrë nga INSTAT. Numri i emigrantëve është parashikuar me ulje graduale gjatë gjithë periudhës së parashikimit nga rreth 18,500 persona në vitet e para të periudhës së parashikimit në 1,800 në vitin 2060 dhe pastaj është mbajtur zero deri në vitet e fundit të periudhës së parashikimit.

➤ **Supozimet për treguesit e punës**

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për meshkujt dhe femrat për çdo moshë është mbajtur konstante gjatë të gjithë periudhës së parashikimit.

Shkalla e papunësisë për meshkujt nga 15.3% në vitin 2012 shkon në 12% në vitin 2020, në 10% në vitin 2050 dhe më pas mbetet konstante deri në vitin 2080.

Shkalla e papunësisë për femrat nga 12.6 në vitin 2012 shkon në 11.5% në vitin 2020 dhe në 10% në vitin 2050, ku barazohet me shkallën e papunësisë për meshkujt dhe më pas mbetet konstante ashtu si për meshkujt deri në vitin 2080.

➤ **Supozimet makroekonomike**

	2012	2013	2014	2015	2016	2020	2025	2035	2055	2080
Rritja reale e GDP	1.3	0.7	2.1	3.3	4.2	4.5	4.3	4.0	3.0	2.5
Inflacioni	2.0	1.9	2.7	2.8	3.0	3.0	3.0	3.0	2.5	2.5

Supozimet makroekonomike afatgjatë janë hartuar nga specialistët e Ministrisë së Financave.

➤ **Supozimet për numrin e kontribuesve**

Ulja e shkallës së papunësisë dhe si pasojë rritja e numrit të të punësuarve sjell gjithashtu rritjen e numrit të kontribuesve.

Përqindja e numrit të kontribuesve urbanë ndaj popullsisë në moshë pune është supozuar të rritet gradualisht gjatë gjithë periudhës së parashikimit. Raporti i numrit të kontribuesve urbanë me popullsinë në moshë pune rritet gradualisht nga 24.5% të totalit të popullsisë në moshë pune në vitin bazë në 33.1% në vitin 2080.

Numri i kontribuesve në skemën rurale është supozuar në ulje deri në vitin e fundit të parashikimit. Është parashikuar që numri i kontribuesve ruralë në vitin e fundit të parashikimit të jetë sa 40% e numrit të kontribuesve në fillim të periudhës. Arsyet e uljes së numrit të kontribuesve në skemën rurale janë: skema nuk është inkurajuese, lëvizja e popullsisë rurale drejt zonave urbane, niveli i ulët i produktivitetit në fshat dhe kultura e dobët në drejtim të derdhjes së kontributeve për sigurimin e pleqërisë.

Në Opsionet 1 dhe 2, për numrin e kontribuesve të skemës urbane janë bërë dy lloj supozimesh. Supozimi optimist, i cili e rrit numrin e kontribuesve nga 27% të popullsisë në moshë pune në vitin 2015 (viti i parë i reformës) në 40% në vitin 2030 dhe në 54.5% në vitin e fundit të parashikimit. Supozimi pesimist, i cili është bërë njëlloj si në skenarin bazë. Supozimet për numrin e kontribuesve në skemën rurale mbeten të pandryshuara për të gjitha opsionet.

➤ **Supozimet për moshën e daljes në pension**

Mosha ligjore e daljes në pension është 65 për meshkujt dhe 60 për femrat dhe mbetet e pandryshuar gjatë gjithë periudhës së parashikimit në skenarin bazë. Në opsionet me reformë, mosha është rritur gradualisht si për burrat dhe për gratë siç është përmendur më sipër.

Mosha ligjore e daljes në pension për femrat në skemën rurale është e ndikuar fuqimisht nga numri i nënave me shumë fëmijë, të cilat dalin në moshën 50 vjeç. Për skemën e fshatit mosha e femrave është marrë 57.6 në vitin bazë dhe rritet gradualisht deri në 60 në vitin 2025. Në opsionet me reformë, mosha e daljes në pension për femrat në këtë skemë do të rritet gradualisht duke u barazuar me atë të femrave në skemën urbane në vitin 2025 dhe më pas ndjek ritmin e rritjes së moshës së daljes në pension të femrave në skemën urbane.

➤ **Supozimet për indeksimin e pensioneve**

Për **pensionet e skemës urbane apo rurale** për vitet 2012 e 2013 janë vendosur shifrat reale të rritjes së masës së pensioneve sipas VKM “Për rritjen e pensioneve” për vitet përkatëse. Për vitet në vijim pensionet janë indeksuar sipas inflacionit.

Mosha ligjore e daljes në pension është 65 për meshkujt dhe 60 për femrat dhe mbetet e pandryshuar gjatë gjithë periudhës së parashikimit në lidhje me projeksionet për skenarin bazë.

Përsa u përket projeksioneve të opsioneve për reformë, mosha është rritur gradualisht siç është përmendur më sipër.

Mosha ligjore e daljes në pension për femrat në skemën rurale është e ndikuar fuqimisht nga numri i nënave më shumë fëmijë të cilat dalin në moshën 50 vjeç. Për skemën e fshatit mosha e femrave është marrë 57.6 sa në vitin bazë. Për sa u përket projeksioneve të opsioneve për reformë, mosha e daljes në pension për femrat në këtë skemë do të rritet gradualisht duke u barazuar me atë të femrave në skemën rurale në vitin 2032.

➤ **Supozime për përqindjen e kontributit për pensione**

Në skemën urbane përqindja e kontributit për pensione është 21.6 dhe mbetet e pandryshuar deri në vitin e fundit të parashikimit.

Në skemën rurale të vetëpunësuarit në bujqësi derdhin kontribut në masa të përcaktuara me VKM çdo vit (e ndryshme për zonat fushore e malore), masa të cilat janë shumë më të vogla se kontributi që derdh një i vetëpunësuar në qytet. Pjesa tjetër e këtij kontributi deri tek kontributi minimal, derdhet nga Buxheti i Shtetit.

Sipas strategjisë së barazimit të kontributit minimal të skemës rurale me atë urbane, në model është supozuar që përqindja e kontributit që derdhin të vetëpunësuarit në bujqësi të rritet gradualisht (me të njëjtën masë reduktohet kontributi që Buxheti i Shtetit derdh për llogari të të vetëpunësuarve në bujqësi) derisa në vitin 2025 masa e kontributit që paguan një i vetëpunësuar në bujqësi të barazohet me kontributin minimal. Në këtë vit, përqindja e kontributit për pensione që derdh i vetëpunësuarit në bujqësi do të jetë 21.6% dhe kjo përqindje do të mbetet konstante deri në vitin e fundit të periudhës së parashikimit. Nën Opsionet 1 dhe 2 është supozuar se kontributet e fshatit me ato të qytetit do të barazohen në vitin 2017.